

**DHUNA NË MARRËDHËNIET INTIME  
NË ADOLESHENCË NË SHQIPËRI**

**STUDIM**

**TIRANË, 2019**

Ky studim është realizuar nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) në kuadrin e programit “Mbrojtje dhe Promovim i të Drejtave të Grave në Shqipëri”, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze.

“Ky material është plotësisht i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida). Sida nuk është domosdoshmërisht dakort me opinionin e shprehur.”



### **Autorët**

Mirela Arqimandriti

Odetta Lena

Ana Uka

Migena Kapllanaj

### **Kontribuan në të gjitha fazat e studimit:**

Ines Leskaj

Irena Shtraza

@Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - AWEN

Adresa: Rr. “Vaso Pasha”, P.16, Shk. 1/4, Tiranë

Web: [www.awenetwork.org](http://www.awenetwork.org)

Kontakt: [info@awenetwork.org](mailto:info@awenetwork.org)

Referenca e botimit: *Arqimandriti M., Lena O., Uka A., Kapllanaj M., Dhuna në marrëdhëniet intime në adoleshencë në Shqipëri, AWEN, 2018.*

Design & Layout

Elzana Agolli

Shtypur në shtypshkronjën Media Print

# Falenderime

Studimi “Dhuna në marrëdhëniet intime mes adoleshentëve në Shqipëri”, është përgatitur nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqiptare (AWEN) përmes mbështetjes financiare të Qeverisë Suedeze. AWEN falenderon Qeverinë Suedeze për mbështetjen e idesë për realizimin e këtij studimi të parë kombëtar rreth dhunës në marrëdhëniet intime mes të rinjve, ide që lindi nga nevoja për të kuptuar më mirë dinamikat dhe perceptimet ndaj dhunës në marrëdhëniet e para intime mes të rinjve, në mungesë të një studimi të tillë në vendin tonë. Realizimi i këtij studimi është i një rëndësie të veçantë për Rrjetin e Fuqizimit të Gruas në Shqipëri.

AWEN dhe grupi i studjueseve u janë thellësisht mirënjohës përfaqësueseve të të gjitha organizatave partnere të AWEN nga veriu në jug, të përmendura më poshtë, që lehtësuan mbledhjen e informacionit nëpërmjet kontaktimit të të rinjve/rejave dhe shpërndarjes së pyetësorëve në të gjithë vendin.

- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë
- Forumi i Gruas Elbasan
- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë
- Shoqata e Grave me Probleme Sociale
- Shoqata Unë Gruaja, Pogradec
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë
- Shoqata Agritra Vizion, Peshkopi
- Shoqata Gruaja tek Gruaja, Shkodër
- Shoqata Jona, Sarandë
- Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare, Tiranë

Në mënyrë të veçantë AWEN dhe autoret falenderojnë përzemërsisht të gjithë ata të rinj e të reja në të gjithë Shqipërinë që u bënë pjesë e këtij hulumtimi, duke ndarë me ne perceptimet dhe përvojat e tyre intime dhe duke na hapur kështu një dritare të re drejt të kuptuarit sa më mirë të fenomenit të dhunës në marrëdhëniet intime në adoleshencë. Pa kontributin e këtyre të rinjve realizimi me sukses i këtij studimi do ishte i pamundur.

AWEN u është thëllësisht mirënjohës autoreve të këtij studimi që me shumë profesionalizëm dhe përkushtim realizuan këtë studim kombëtar gjatë periudhës janar – shtator 2018. AWEN shpreh gjithashtu mirënjohjen për organizatën anëtare Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, që vuri në shërbim të studimit databazat rreth shkollave të mesme publike që dispononte, si dhe hapësirat dhe asetet e zyrës së organizatës.

*Lexim të këndshëm,  
Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri*

# Tabela e përmbajtjes

<b>FALENDERIME</b> .....	<b>3</b>
<b>SHKURTIME</b> .....	<b>9</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>11</b>
<b>PËRSE KY STUDIM</b> .....	<b>15</b>
<b>METODOLOGJIA E STUDIMIT</b> .....	<b>10</b>
<i>Kampionimi</i> .....	17
<i>Kriteret e pjesëmarrjes në studim</i> .....	19
<i>Instrumenti i mbledhjes së të dhënave</i> .....	19
<i>Mbledhja e të dhënave</i> .....	21
<i>Përpunimi i të dhënave</i> .....	21
<i>Metoda cilësore e studimit</i> .....	21
<i>Kufizime të studimit</i> .....	22
<b>RISHIKIM LITERATURE</b> .....	<b>23</b>
DHUNA NË MARRËDHËNIET INTIME .....	23
DHUNA NË MARRËDHËNIET INTIME MIDIS ADOLESHENTËVE .....	27
SIGURIA NË KOMUNITET .....	29
KËNDVËSHTRIMET E ADOLESHENTËVE MBI DHUNËN DHE EKSPERIENCAT E TYRE ME DHUNËN .....	30
ALKOOLI, DUHANI E DROGA DHE MARRËDHËNIA E KËTYRE SUBSTANCAVE ME DHUNËN NË MARRËDHËNIET INTIME..	31
FAMILJA DHE MIQTË NË LIDHJE ME DHUNËN NË DHMI .....	32
BESIMET DHE QËNDRIMET E ADOLESHENTËVE NË LIDHJE ME DHUNËN NË MARRËDHËNIET INTIME .....	34
<b>ANALIZË E GJETJEVE</b> .....	<b>36</b>
KARAKTERISTIKAT E PJESËMARRËSVE DHE EKSPERIENCAT NË MARRËDHËNIET INTIME .....	36
<i>Informacion demografik</i> .....	36
PJESA E PARË – DHUNA NË MARRËDHËNIET INTIME NË ADOLESHENCË.....	39
<i>Ekspozimi i të rinjve ndaj dhunës</i> .....	39
<i>Eksperiencat e të rinjve me marrëdhëniet intime</i> .....	42
<i>Këndvështrimet e të rinjve mbi sjelljet në marrëdhëniet intime</i> .....	45
<i>Shfaqja e dhunës në marrëdhëniet intime tek të rinjtë 16-19 vjeç</i> .....	48

<i>Marrja ndihmë nga të tjerët në rast të dhunës në marrëdhënie intime.....</i>	52
<i>Të dhëna nga fokus grupet.....</i>	54
<b>PJESA E DYTË - SJELLJE TË RREZIKSHME .....</b>	<b>56</b>
<i>Eksperiencat e të rinjve me duhanin, alkoolin dhe drogën. ....</i>	56
<i>Lidhja ndërmjet sjelljeve të dhunshme dhe konsumimit të alkoolit, duhanit dhe drogave. ....</i>	57
<i>Të dhëna nga fokus grupe.....</i>	58
<b>PJESA E TRETË – SIGURIA, MARRËDHËNIET ME FAMILJEN DHE BESIMET NË LIDHJE ME DHUNËN .....</b>	<b>60</b>
<i>Siguria në komunitet .....</i>	60
<i>Marrëdhënia me familjen dhe miqtë.....</i>	61
<i>Besimet e të rinjve në lidhje me dhunën.....</i>	65
<i>Qëndrimi i të rinjve ndaj dhunës ndaj vajzave dhe grave .....</i>	67
<i>Të dhëna nga grupet e fokusuara .....</i>	68
<b>DISKUTIME, REFLEKTIME DHE SUGJERIME NË LIDHJE ME DHUNËN NË MARRËDHËNIET INTIME NË ADOLESHENCË NË SHOQËRINË SHQIPTARE .....</b>	<b>71</b>
<i>DISKUTIM DHE REFLEKTIME NË LIDHJE ME DHUNËN NË MARRËDHËNIET INTIME NË ADOLESHENCË .....</i>	71
<i>SUGJERIME PËR VEPRIM NË LIDHJE ME DHUNËN NË MARRËDHËNIET INTIME NË ADOLESHENCË NË SHOQËRINË SHQIPTARE.....</i>	73
<i>Sugjerime për kërkime të thelluara shkencore .....</i>	73
<i>Sugjerime për Politika, Ligje e Strategji .....</i>	73
<i>Propozime për strategji për parandalim të DhMI-së bazuar në përvojat më të mira botërore.....</i>	74
<i>Programe të ndryshme sociale që duhet të fillojnë që nga klasa e 7-të apo e 8-të.....</i>	77
<i>Përfshirja e shembujve dhe njerëzve pozitivë .....</i>	79
<b>REFERENCA .....</b>	<b>81</b>
<b>ANEKSE.....</b>	<b>87</b>
<i>KONCEPTE GJINORE TË PËRDORURA NË KËTË STUDIM .....</i>	87
<i>PYETËSORI.....</i>	89

## Lista e tabelave

TABELA 1. TIPI I SHKOLLËS SË PËRFSHIRË.....	17
TABELA 2. NDARJA E KAMPIONIT SIPAS QARQEVE.....	18
TABELA 3. METODAT KONTRACEPTIVE QË PËRDORIN TË RINJTË.....	44

## Lista e figurave

FIGURA 1. SHPËRNDARJA DEMOGRAFIKE E KAMPIONIT .....	36
FIGURA 2. EKSPOZIMI NDAJ DHUNËS NËPËRMJET MIQVE/TË NJOHURVE .....	27
FIGURA 3. FORMAT E DHUNËS NDAJ TË CILAVE JANË EKSPOZUAR TË RINJTË DHE TË REJAT – NGA PARTNERI OSE FAMILJA.....	29
FIGURA 4. MOSHA MESATARE E KRIJIMIT TË MARRËDHËNIEVE INTIME .....	42
FIGURA 5. NUMRI I PARTNERËVE INTIMË .....	43
FIGURA 6. PËRDORIMI I METODAVE KONTRACEPTIVE .....	44
FIGURA 7. KONSUMI I DUHANIT, ALKOOLIT DHE LËNDËVE TË TJERA GJATË 12 MUAJVE TË FUNDIT DHE LIDHJA E TYRE ME KRYERJEN E MARRËDHËNIEVE SEKSUALE.....	45
FIGURA 8. SHKALLA E PRANIMIT TË DHMI NGA TË RINJTË.....	46
FIGURA 9. SHKALLA E PRANIMIT TË DHMI MES ADOLESHENTËVE QË KANË KRYER MARRËDHËNIE SEKSUALE, KUNDREJT ATYRE QË NUK KANË KRYER MË PARË MARRËDHËNIE SEKSUALE .....	47
FIGURA 10. SHFAQJA E DHUNËS NË MARRËDHËNIET INTIME (DHMI) MES ADOLESHENTËVE .....	48
FIGURA 11. LLOJI I DHUNËS SË PËSUAR NGA PARTNERI/A. VETËM ATA QË JANË APO KANË QENË NË NJË MOMENT TË JETËS SË TYRE NË NJË MARRËDHËNIE INTIME.....	49
FIGURA 12. SHKALLA E DHUNËS SË PROVUAR NGA PARTNERI/JA NË MARRËDHËNIET INTIME, SIPAS FAKTORËVE TË RREZIKUT .....	50
FIGURA 13. MARRËDHËNIA NDËRMJET DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE DHE DHUNËS NË MARRËDHËNIET INTIME .....	51
FIGURA 14. MODELET E TË KËRKUARIT NDIHMË NË RAST DHUNE NGA PARTNERI .....	52
FIGURA 15. MODELI I TË KËRKUARIT NDIHMË NË RAST DHUNE NGA PARTNERI SIPAS GJINISË.....	53
FIGURA 16. MODELI I TË KËRKUARIT NDIHMË NË RAST DHUNE NGA PARTNERI SIPAS AKTIVITETI SEKSUAL .....	54
FIGURA 17. KONSUMI I DUHANIT, KANABISIT DHE PIJEVE ALKOOLIKE.....	56
FIGURA 18. KONSUMIMI I LËNDËVE DUHANIT ALKOLIT DHE LËNDËVE NARKOTIKE DHE TË ARRESTUAR NGA POLICIA, SIPAS GJINISË, GJATË 12 MUAJVE TË FUNDIT .....	57
FIGURA 19. MARRËDHËNIA NDËRMJET KONSUMIT TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE DHE SJELLJEVE TË DHUNSHME.....	58
FIGURA 20. PERCEPTIMI MBI SIGURINË NË SHTËPI, KOMUNITET DHE SHKOLLË.....	60
FIGURA 21. PERCEPTIMI MBI SIGURINË NË SHTËPI, KOMUNITET DHE SHKOLLË SIPAS GJINISË.....	61
FIGURA 22. KONTROLLI PRINDËROR SIPAS GJINISË.....	62
FIGURA 23. MARRËDHËNIA ME PRINDËRIT.....	62
FIGURA 24. MARRËDHËNIA ME PRINDËRIT SIPAS RAJONEVE.....	63
FIGURA 25. FREKUENCA E KOMUNIKIMIT ME PRINDËRIT .....	64
FIGURA 26. BESIMET E TË RINJVE NË LIDHJE ME SHKAQET E DHUNËS .....	65
FIGURA 27. QËNDRIMET E TË RINJVE NDAJ SJELLJEVE TË DHUNSHME .....	66
FIGURA 28. DHUNA NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE ËSHTË PROBLEM SERIOZ NË KOMUNITET.....	67
FIGURA 29. DHUNA NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE ËSHTË ÇËSHTJE SERIOZE NË KOMUNITET.....	68





## Shkurtime

AWEN	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
DhKG	Dhunë ndaj Grave
DhMI	Dhunë në Marrëdhënie Intime
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MD	Ministria e Drejtësisë
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
(MMSR)MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizatë Joqeveritare (Jo-fitimprurëse)
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PShSh	Policia e Shtetit Shqiptar
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave



## Përmbledhje ekzekutive

Dhuna në Marrëdhëniet Intime (DhMI) ashtu si në gjithë botën edhe në Shqipëri, prek kryesisht vajzat e gratë dhe përpjekjet për ta luftuar kërkojnë një kuptim të shkallës dhe natyrës së saj nëpërmjet të dhënave të besueshme, sistematike dhe të krahasueshme. Të dhënat janë të nevojshme për të matur përhapjen dhe pasojat e DhMI në adoleshencë, për të monitoruar përgjigjet e shtetit ndaj saj dhe për të vlerësuar politikat që e luftojnë atë. Kërkesa për të dhëna administrative me cilësi të lartë është gjithashtu në përputhje me angazhimet ndërkombëtare për të luftuar dhunën kundër gruas, siç përcaktohet në Direktivën 2012/29 / BE (Direktiva për të Drejtat e Viktimave) dhe Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

Ky studim ka si qëllim kryesor paraqitjen e një pasqyre mbi dhunën në marrëdhëniet intime në adoleshencë, duke ofruar një analizë të plotë të shfaqjes së fenomenit dhe karakteristikave të dhunës ndaj partnerit/es intim/e në moshat nga 16-19 vjeç në Shqipëri, parë nën këndvështrimin gjinor. Më tej studimi ka qëllim të zbulojë faktorët e rrezikut në nivel individual (*përdorimi i duhanit, alkoolit apo drogës*), familjar (*dhuna në familje*) dhe komunitar (*siguria në komunitet*) që nxisin viktimizimin dhe/apo ushtrimin e dhunës mes adoleshentëve.

Dhuna në Marrëdhëniet Intime (DhMI), e cila përshkruhet si kontrolli i një personi ndaj një personi tjetër, përmes abuzimit fizik, psikologjik, seksual, financiar dhe/ose dixhital, ka pasoja afatgjata shëndetësore, psikologjike, arsimore dhe ekonomike për personat që e kanë përjetuar dhe kanë mbijetuar apo vazhdojnë të jenë në një marrëdhënie të dhunshme dhe për gjithë shoqërinë.

Në këtë studim morën pjesë 1036 të rinj të moshës 16-19 vjeç, nxënës të shkollave të mesme publike në vend, 428 prej të cilëve ishin djem dhe 593 ishin vajza dhe 15 pjesëmarrës që nuk e kanë specifikuar gjininë. 56 përqind e të anketuarve jetonin në zonat urbane dhe 44 përqind në zonat rurale. 2 përqind e të rinjve i përkisnin komunitetit Rom dhe Egjiptian. I gjithë studimi është analizuar nga pikëpamja gjinore.

## Gjetjet kryesore nga studimi i dhunës në marrëdhëniet intime tek të rinjtë 16-19 vjeç:

- Mes adoleshentëve/eve që kanë qenë ndonjëherë në një marrëdhënie intime, 22 përqind raportojnë të kenë përjetuar dhunë nga partneri/partnerja.
- DhMI mes vajzave që kanë qenë ndonjëherë në një marrëdhënie intime raportohet të jetë 28 përqind, ndërsa mes djemve rreth 20 përqind.
- 3 herë më shumë vajza se djem, dhunohen fizikisht (18 përqind vajza kundrejt 6 përqind djem). 20 përqind e vajzave kundrejt 8 përqind e djemve kërcënohen apo poshtërohen.
- Dhuna në familje, ekspozimi ndaj dhunës, toleranca ndaj sjelljeve të dhunshme, përdorimi i substancave, normat dhe paragjykimet dyfishojnë probabilitetin e përjetimit të dhunës në marrëdhëniet intime në adoleshencë.
- Pothuajse trefishohet mundësia për të hyrë në ciklin e dhunës në marrëdhëniet intime në adoleshencë midis të rinjve e të rejave që kanë përjetuar dhunë në familje.
  - Të dhënat në këtë studim tregojnë se 43 përqind e të rinjve/rejave që kanë qenë viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare janë edhe viktimë e dhunës në marrëdhëniet intime, përkundrajt 16 përqind e atyre që nuk kanë përjetuar dhunë në familje.
  - Adoleshentët/et që kanë në rrethin e tyre të dhunuar/a ose dhunues/e janë pothuaj dy herë më të predispozuar (24 përqind) për të qenë viktimë të dhunës se ata që nuk kanë në rrethin e tyre viktimë ose dhunues/e (13 përqind).
  - Mes adoleshentëve/eve që e konsiderojnë deri diku të pranueshme dhunën, përqindja e viktimave është më e lartë, 36 përqind krahasuar me rreth 18 përqind që e konsiderojnë të papranueshme dhunën.
  - Ata/ato që kanë konsumuar substanca rezultojnë më shpesh edhe dhunues/e edhe viktimë të dhunës në marrëdhëniet intime. 27 përqind e përdoruesve të substancave janë viktimë të DhMI krahasuar me 16 përqind të jopërdoruesve.
- 82 përqind besojnë se vajzat dhe gratë janë më shpesh viktimë të dhunës se djemtë dhe burrat. Gjithashtu, 89 përqind e konsiderojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave si një problem serioz në komunitetin ku jetojnë.
- 35 përqind njohin të paktën një vajzë të dhunuar nga partneri dhe 38 përqind e tyre njohin një vajzë të dhunuar nga familja.

- Rreth gjysma raportojnë se ka pak ose aspak mundësi t'i tregojnë dikujt në rast se janë viktimë e një dhunimi psikologjik, fizik apo seksual. Në përgjithësi flasin rrallë me prindërit, por edhe më rrallë për marrëdhëniet intime. Biseda të tilla vazhdojnë të mbeten tabu për shoqërinë shqiptare, por nga ana tjetër prindërit vazhdojnë të ushtrojnë kontroll mbi jetën e adoleshentëve/eve.
  - Të dhënat e studimit tregojnë se rreth 40 – 45 përqind e të rinjve e të reja flasin rrallë ose shumë rrallë me prindërit.
  - Rreth 60 përqind flasin me prindërit e tyre për planet e së ardhmes.
  - 58 përqind nuk flasin asnjëherë me prindërit e tyre për marrëdhëniet intime, dhe rreth 19 përqind e tyre flasin shumë rrallë.
  - Mbi 80 përqind shprehen se prindërit e tyre duan të dinë me kë po shoqërohen dhe ku janë fëmijët e tyre.
- Studimi nxorri në pah sjelljet kontrolluese të adoleshentëve/eve ndaj partnerëve/eve në marrëdhënie intime.
  - 64 përqind e konsiderojnë si të pranueshëm kontrollin e aktivitetit të partnerit/es në rrjetet sociale.
  - 52 përqind e konsiderojnë të pranueshme të përcaktosh me kë të shoqërohet partneri/ja.
  - 38 përqind e konsiderojnë si të pranueshme ti bërtasësh partnerit/es kur janë vetëm.
  - 28 përqind e konsiderojnë të pranueshme të injorosh partnerin/en dhe të refuzosh të flasësh me të.
- Rreth 90 përqind shprehen se lagjia ku jetojnë është e sigurt, ndjehen të sigurt në shtëpi gjatë natës, ndjehen të sigurt kur kalojnë kohë në lagje gjatë ditës, si dhe ndihen të sigurt në shkollë.
- 75 përqind besojnë që aktivitetet kriminale që ndodhin në lagjen e tyre kryhen nga të tjerë jashtë lagjes së tyre, por 25 përqind të tjerë mendojnë se kryhen nga persona që jetojnë rreth tyre.
- 75 përqind ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin se dhuna me bazë gjinore shkaktohet nga përdorimi i alkoolit dhe drogës, kundrejt 24 përqind që ishin kundër dhe plotësisht kundër këtij pohimi.

- 77 përqind e të tyre ishin dakord me pohimin që dhuna është e lejueshme në rastet kur përdoret për vetëmbrojtje.
- 34 përqind kanë deklaruar që kanë qenë të paktën një herë në një marrëdhënie intime, dhe 19 përqind e tyre refuzojnë të përgjigjen.
- Moshë mesatare e raportuar e fillimit të një marrëdhënie intime është rreth 16 vjeç, me djemtë që hyjnë në një marrëdhënie intime 15.8 vjeç, rreth një vit më herët se vajzat (16.8 vjeç).
- Të dhënat tregojnë se 54 përqind e vajzave dhe 32 përqind e djemve që kanë qenë në marrëdhënie intime, nuk kishin përdorur asnjë mjet mbrojtës gjatë marrëdhënieve intime.
- Gati 1 në 2 të rinj/reja të intervistuar, frekuentues të shkollës së mesme, ka provuar alkoolin ose duhanin në jetën e tij, dhe 1 në 10 të rinj ka provuar marijuanën/apo kanabisin.

## Përse ky studim

Dhuna në marrëdhëniet intime në adoleshencë është një çështje e pa studiuar më parë në Shqipëri. Ndoshta ka patur tema të realizuara nga studentë, por që nuk njihen. Përsa i përket dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në vitin 2017, numërohen në terma absolutë 3.243 gra të dhunuara që kanë raportuar në organet përkatëse (Instituti i Statistikës, 2018). Përqindja më e lartë e grave që kanë raportuar dhunën në familje, është në qarkun e Tiranës me 36 përqind e totalit, ndjekur nga qarku i Durrësit me 14 përqind, ndërsa qarku i Kukësit dhe ai i Dibrës kanë përqindjen më të ulët, përkatësisht, 0,9 dhe 1,5 përqind gra të dhunuara që kanë raportuar, kjo ndoshta për shkak të kulturës së ulët të raportimit dhe paragjytimeve që mbizotërojnë në këto qarqe (po aty INSTAT, 2018).

Dhuna në marrëdhëniet intime mes adoleshentëve është e shoqëruar me pasoja të tilla si: shqetësim psikologjik, arritje të ulëta akademike dhe marrëdhënie të këqija shoqërore (Fincham, Cui, Braithwaite, dhe Pasley, 2008). Shumë studime botërore, kanë gjetur se djemtë dhe vajzat janë të viktimizuar nga partnerë intimë (Brooks-Russell e të tjerë, 2013). Gjithashtu, asnjëherë nuk është vëzhguar marrëdhënia mes dhunës në familje me sjelljet e dhunshme mes adoleshentëve apo viktimizimi në marrëdhëniet e tyre gjatë adoleshencës. Të tjera hulumtime sasiore që janë bërë më parë, kryesisht në SHBA, tregojnë se ka një korrelacion të ngushtë midis viktimizimit, ushtrimit të DhMI dhe përdorimit të alkoolit apo substancave të ndryshme (Temple dhe Freeman, 2011). Në Shqipëri gjendeshin të dhëna në lidhje me këta faktorë, ndaj i përfshimë në studimin tonë. Këndvështrimet e adoleshentëve mbi dhunën janë një tregues i rëndësishëm për praninë e dhunës në marrëdhëniet intime mes të rinjve (Reed e të tjerë, 2011; Temple e të tjerë, 2013), sepse mënyra sesi ata mendojnë rreth këtij fenomeni ul ose rrit rrezikun e shfaqjes së DhMI (McDonell e të tjerë, 2010). Edhe kjo është një çështje e patrajtuar rreth së cilës kishte mungesë studimesh në Shqipëri.

### Objektivat e Studimit

Objektivi kryesor i studimit “Dhuna në marrëdhëniet intime në adoleshencë» është paraqitja e një pasqyre mbi dhunën mes të rinjve në Shqipëri, duke ofruar një analizë të plotë të shfaqjes së fenomenit dhe karakteristikave të dhunës ndaj partnerit/es intim/e në moshat nga 16-19 vjeç në Shqipëri. Një objektivi tjetër i këtij studimi ishte që të zbulonte faktorët

e rrezikut në nivel individual (*p.sh. përdorimi i duhanit, alkoolit apo drogave*), familjar (*p.sh dhuna në familje*) apo komunitar (*p.sh. siguria në lagje*) që nxisin viktimizimin apo ushtrimin e dhunës mes adoleshentëve. Së fundmi, studimi kishte si qëllim të ofronte një këndvështrim të dhunës mes partnerëve intimë mes adoleshentëve nga një perspektivë gjinore.



# Metodologjia e studimit

Për realizimin e këtij studimi, me qëllim grumbullimin e të gjithë informacionit të mundshëm rreth këtij fenomeni në rang kombëtar, janë përdorur dy metoda kërkimore: 1) Metoda kërkimi sasior dhe 2) Metoda kërkimi cilësor.

## Metodologjia sasior e Studimit

Për realizimin e këtij e studimi, u zhvillua një anketë në nivel kombëtar me pjesëmarrjen e 1036 personave të moshës 16 – 19 vjeç, frekuentues të shkollave të mesme publike në Shqipëri gjatë vitit shkollor 2017 - 2018. Në përzgjedhjen e të anketuarve u përdor një skemë e tillë kampionimi që mundësoi përfaqësim sa më të plotë të kësaj grupmoshe nga e gjithë Shqipëria.

### Kampionimi

Përzgjedhja e të anketuarve u krye sipas metodës PPS<sup>1</sup> të shtresëzuar sipas rajoneve gjeografike. Si kornizë kampionimi (*sampling frame*) u përdor lista e shkollave të mesme publike (të përgjithshme dhe ato profesionale) të cilat shërbyen si njësi parësore kampionimi, ndërsa numri i nxënësve të regjistruar në shkolla shërbeu si njësi matjeje e madhësisë. Sipas PPS, algoritmi i përdorur i jep mundësi më të mëdha shkollave që kanë një numër më të madh nxënësish, ose e thënë ndryshe, shkollat më të populluara, kanë mundësi më të larta përzgjedhjeje se ato më pak të populluara. Në total lista e shkollave përmban 397 shkolla të mesme publike si dhe informacion mbi numrin e nxënësve të regjistruar në atë shkollë.

Tabela 1. Tipi i shkollës së përfshirë

Tipi i shkollës	Përfshirja
Gjimnaz	Po
Lice artistik	Po
Shkollë e mesme profesionale	Po
Privat	Jo
Tjetër (edukim i specializuar)	Jo

1 Probability Proportional to Size – mundësia e përzgjedhjes proporcionale me madhësinë e shtresës

Në fazën e parë, u përzgjedhën rastësisht 100 njësi kampionimi (korrespondentë të 87 shkollave<sup>2</sup>) në mënyrë proporcionale me numrin e nxënësve të regjistruar, të shtresëzuar sipas tre rajoneve statistikore: Qendër, Veri dhe Jug të përcaktuara nga INSTAT për vrojtimet kombëtare. Pastaj, për çdo njësi kampionimi të përzgjedhur, u kryen në total 10 intervista, numër ky i arsyeshëm për të ruajtur ekuilibrin midis strukturës dhe saktësisë së kampionit.

**Tabela 2. Ndarja e kampionit sipas qarqeve**

Rajoni	Qarku	Numri i shkollave	# i intervistave
Veri	Dibër	7	100
	Durrës	7	70
	Kukës	2	20
	Lezhë	7	70
	Shkodër	6	70
Qendër	Elbasan	9	110
	Tiranë	20	270
Jug	Berat	7	70
	Fier	5	70
	Gjirokastrë	3	30
	Korçë	9	110
	Vlorë	5	50
Total			<b>1040</b>

*Numri total i intervistave të kryera është 1036, pasi 4 u përjashtuan.*

Sistemi për përzgjedhjen e vitit dhe klasës (psh. viti I, Klasa A), u parametrizua me dy variablat “vit” dhe “klasë” për të cilat përzgjedhja e rastësishme u ekzekutua tre herë. Në fazën e tretë, pasi u përzgjedhën shkolla, viti dhe klasa, intervistuesi përzgjodhte të intervistonte nxënësin e 7-të, duke e filluar numërimin nga e majta e tij, derisa të arrinte numrin 3 të intervistave në atë klasë. Intervista e 10-të përzgjodhet në klasën e zgjedhur të vitit të fundit (viti i tretë). Nëse personi i përzgjedhur ishte nën 16 vjeç apo refuzonte të merrte pjesë në studim, përzgjidhej personi ngjitur me të. Të dhjetë nxënësit e përzgjedhur, më vonë, u mblodhën të gjithë në një sallë, dhe pasi iu shpjegua qëllimi i studimit, u lanë të pavarur në plotësimin e pyetësorit.

Kriteret e pjesëmarrjes në studim.

Të gjithë nxënësit e moshës 16 vjeç e lart që ndiqnin shkollat e mesme publike në Shqipëri, gjatë vitit shkollor 2017 – 2018, ishin të përshtatshëm për të marrë pjesë në studim.

<sup>2</sup> Algoritmi i PPS me parametrat e kërkuar, përzgjedhi 87 shkolla, ku në 11 prej tyre u kryen me shume se 10 intervista

### ***Instrumenti i mbledhjes së të dhënave***

Për këtë studim u përdor një pyetësor i përdorur më parë nga një studim afatgjatë 4-vjeçar i bërë në Karolinën e Jugut të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky studim kishte për qëllim të ekzaminonte trajektoren zhvillimore të viktimizimit dhe ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet intime midis adoleshentëve në pjesën rurale të asaj zone. Ky pyetësor është përshtatur sipas kulturës dhe kontekstit shqiptar dhe më pas është zbatuar ndaj një kampioni kombëtar të shtresëzuar, të rastësishëm të adoleshentëve të grupmoshës 16-19 vjeç që frekuentojnë shkollat e mesme publike në qarqe të ndryshme të Shqipërisë.

Pyetësori mat qëndrimet dhe perceptimet e nxënësve të shkollave të mesme publike ndaj dhunës në familje dhe në marrëdhëniet intime; përvojën e tyre me dhunën gjatë jetës së tyre dhe të shokëve; pikëpamjet e pranueshmërisë së sjelljeve të dhunshme në marrëdhëniet intime dhe ato familjare; qëndrimet dhe përvojat e tyre me përdorimin e substancave të ndryshme si duhani apo alkooli; dhe pikëpamjet e tyre ndaj aspekteve të ndryshme të dhunës në marrëdhëniet intime.

Pyetësori përfshin 11 seksione:

1. **Siguria.** Në këtë seksion përfshihen pyetje rreth sigurisë në lagje si *'Lagja ime është një vend i sigurt për për të jetuar'* ose *'Unë ndihem i/e sigurtë në shtëpi gjatë natës'*. Matja këtu është kryer në shkallën Likert nga 1- 'plotësisht kundër' deri në 4- 'plotësisht dakord'.
2. **Këndvështrimet e adoleshentëve mbi dhunën** përfshin deklaratat rreth pikëpamjeve të ndryshme mbi atë që mund të shkaktojë dhunë ose kontribuojnë në sjellje të dhunshme të tilla si: *'Dhuna mund të jetë mënyra e vetme për njerëzit që të marrin atë që ata duan në jetë'* ose *'Vajzat/gratë dhunohen më shumë se djemtë apo burrat'* me opsione të ndryshme nga 1- 'plotësisht kundër' deri në 4- 'plotësisht dakord'.
3. **Përvojat e adoleshentëve me dhunën:** në këtë seksion përfshihen pyetje mbi qëndrimet dhe përvojat me dhunën në familje dhe në marrëdhëniet intime dhe përfshin pyetje të tilla si: *'Sa problem serioz mendon se është dhuna kundër grave dhe vajzave në komunitetin tënd?'* me alternativa që ndryshojnë nga 1 – 'Problem serioz' në 4- 'Nuk është fare problem' apo *'A ka qenë ndonjë nga vajzat që ti nje personalisht e dhunuar nga pjesëtarët e familjes'* me opsione të ndryshme nga 1- 'Po' deri në 2- 'Jo'.
4. **Përvojat e adoleshentëve me marrëdhëniet intime:** në këtë seksion përfshihen pyetje rreth përvojave të tyre me marrëdhëniet intime duke përfshirë pyetje të tilla si: *'Sa vjeç ke qenë kur ke kryer marrëdhënie seksuale për herë të parë'* me alternativa që ndryshojnë nga 1 – '11 ose më herët' deri në 8 – '18 ose më vonë'.
5. **Këndvështrimet e adoleshentëve mbi sjelljet në marrëdhëniet intime** përfshin pyetje rreth qëndrimeve ndaj sjelljeve që mund të shfaqen nga partnerët në një marrëdhënie

intime si: *'Të përcaktosh me kë mund të shoqërohen dhe më kë jo'* apo *'T'i gjuash me shuplaka ose ta godasësh'* me alternative nga 1 – 'absolutisht e papranueshme' deri në 5 – 'plotësisht e pranueshme'.

6. **Përvojat e tyre me dhunën në marrëdhëniet intime:** në këtë seksion përfshihen pyetje rreth përvojave të tyre me dhunën në marrëdhëniet intime si: *'A je ndjerë ndonjëherë i/e kërcënuar, i/e poshtëruar ose i/e kontrolluar nga një partner/e në një marrëdhënie intime, 'Nëse po, a ka ndodhur kjo gjatë 12 muajve të fundit'* apo *'A je detyruar ndonjëherë nga ndonjë partner/e të kesh marrëdhënie seksuale pa dëshirën tënde, Nëse po, a ka ndodhur kjo gjatë 12 muajve të fundit'*, me opsione nga 1- 'Po' deri në 2- 'Jo'.
7. **Përvojat e adoleshentëve me duhanin, alkoolin, dhe drogën:** Ky seksion përfshin pyetje rreth disa sjelljeve me rrezikshmëri që të rinjtë mund të shfaqin gjatë moshës 10 ose më pak deri në 17 ose më vonë të tilla si: *'Sa vjeç ke qenë kur ke tymosur fillimisht një cigare, qoftë edhe vetëm një të thithur'*, apo *'Pive më shumë se një ose dy gllënjka birrë, verë ose alkool tjetër me opsione si 1- 'Asnjëherë' deri në 9- '17 ose mbi 17 vjeç'*.
8. **Familja dhe miqtë** është një seksion që përfshin pyetje në lidhje me perceptimet e të anketuarve në atë që ata mendojnë për familjen ose grupin e miqve me të cilët zakonisht kalojnë kohën, të tilla si: *'Mendo për një shok/shoqe apo grup shoqëror me të cilët shoqërohesh, a mund të thuash se ata: Përfshihen në telashe (veprimtari të rrezikshme)'* apo *'Kanë mbarëvajtje të mirë në shkollë'* me opsione nga 1 – 'Aspak i vërtetë' deri në 4 – 'Plotësisht e vërtetë'.
9. **Familja** në këtë seksion përfshihen përvojat e të anketuarve në familjen e tyre me pyetje të tilla si: *'A ke patur ndonjëherë frikë nga familjarët e tu se mund të të rrezikojnë jetën?'* *'Nëse po, a ka ndodhur kjo gjatë 12 muajve të fundit'* me opsione që ndryshojnë nga 1 – 'Po' në 2- 'Jo'.
10. **Marrja e Ndhmës:** në këtë seksion përfshihen pyetje si: *'Nëse personi me të cilin/ën ti je në një marrëdhënie intime po të kërcënon, poshtëron ose tenton të të kontrollojë, apo 'Nëse personi me të cilin/ën ti je në një marrëdhënie intime të lëndon/dhunon fizikisht, sa mundësi ka t'i tregosh: njërit prej prindërve ose te dyve, një shoku/shoqeje, një mjeku/eje me opsione që fillojnë nga 1- 'Aspak mundësi' në 4- 'Shumë mundësi'*.
11. **Informacion demografik** si seksion përfshin pyetje rreth moshës, gjinisë, kombësisë etj.

### ***Mbledhja e të dhënave***

Të dhënat për këtë studim janë mbledhur gjatë periudhës Mars – Maj 2018. Të gjithë anketuesit/et e përfshirë/a në studim, 24 në total, u trajnuan formalisht për mënyrën se si do

të mbledhin të dhënat nga adoleshentët. Anketuesit/et, u pajisën paraprakisht me emrat e shkollave, klasat dhe adresat përkatëse, në të cilat duhej të shkonin fizikisht për të mbledhur të dhënat nga adoleshentët. Anketuesit/et informuan të rinjtë/të rejat e përzgjedhur/a mbi qëllimin e studimit dhe lexuan përkufizimet mbi disa nga temat e shtjelluara në pyetësor. Protokolle i kësaj ankete, kërkoi që të ruhej me çdo lloj mënyre anonimiti i personit që merrte pjesë në studim. Pyetësi u vetë-administrua nga pjesëmarrësit/et nga fillimi deri në fund. Anketuesit/et në asnjë moment nuk ndërhyjnë apo kontrollojnë plotësimin e tij.

### ***Përpunimi i të dhënave***

Të dhënat u analizuan duke përdorur paketën statistikore IBM SPSS, Versioni 20. Testi statistikor *chi katror* u përdor për të vlerësuar lidhjet statistikore midis kategorive të variabëlve. Proporcionet e thjeshta u përdorën për të vlerësuar prevalencën, kurse variablat numerike u krahasuan duke përdorur *testin - t* të studentit. Në raport janë përfshirë vetëm rezultatet statistikisht domethënëse. Në krahasimin e proporcioneve u përdor një nivel domethënie statistikore prej 95 përqind. Në krijimin e profileve të të rinjve bazuar në një bashkësi pyetjesh, u përdorën më vehte ose në kombinim metodat e mëposhtme:

- PCA - Principal Component Analysis
- K-means Cluster
- Two-way cluster

### ***Metoda cilësore e studimit***

Metoda e kërkimit cilësor na mundëson përshkrime komplekse sesi individët e perceptojnë apo përjetojnë një çështje të caktuar duke u influencuar nga sjelljet, besimet, mendimet, emocionet apo marrëdhëniet konfliktuale me individët e tjerë. Kjo metodë kërkimi është shumë efektive në identifikimin e faktorëve socialë si normat sociale, rolet gjinore, dhuna në familje etj. Kur kjo metodë përdoret së bashku me metodën sasiore, mund të ndihmojë në interpretimin dhe të kuptuarit në mënyrë objektive dhe në nivel makro të një realiteti kompleks të një shtate të caktuar dhe implikimet e të dhënave sasiore (Denzin & Lincoln, 2000; Marshall, 2003).

Përsa i përket metodës cilësore si teknikë në këtë studim, janë përdorur **fokus grupet**. Kjo teknikë është efektive në nxjerrjen e të dhënave mbi normat kulturore të një grupi dhe në gjenerimin e pikëpamjeve të ndryshme rreth një çështjeje interesi për grupet apo nëngrupet e përfaqësuar (Kelly, 2003; McLafferty, 2004).

Përzgjedhja e pjesëmarrësve në fokus grupe u krye në bashkëpunim me përfaqësues të organizatave partnere të AWEN që operojnë në nivel vendor, duke përdorur metodën e kampionimit “të qëllimshëm” që do të thotë se për të zhvilluar intervistat janë përzgjedhur anëtarë të grupmoshës 16–19, nxënës të shkollave të mesme publike pjesëmarrëse në këtë

studim, nga të cilët mendohej se mund të mblidheshin të dhënat më të mira të mundshme rreth këtij fenomeni. Metoda e grumbullimit të të dhënave u bazua në marrjen e shënimeve nga ana e intervistuesit/es dhe regjistrimin e zërit pas dakortësimit përgjatë intervistës e cila zgjati rreth 60 minuta.

Në këtë studim, u realizuan gjithsej 6 fokus grupe me nga 8-10 pjesëmarrës, nxënës të shkollave të mesme publike të moshës 16–19 të qarqeve: Tiranë, Korçë, Vlorë, Lezhë, Peshkopi. Për ta bërë sa më të lehtë ndarjen e perceptimeve e përvojave, fokus grupet u zhvilluan të ndara sipas gjinisë. Në total morën pjesë 49 persona nga të cilët 23 vajza dhe 26 djem.

Të rinjtë pjesëmarrës u informuan gjithashtu në lidhje me studimin dhe të drejtën e tyre për të marrë pjesë në studim. Nuk pati të rinj që refuzuan të merrnin pjesë nga grupi i përzgjedhur. Nuk u morën të dhëna identifikuese për pjesëmarrësit, iu kërkua vetëm mosha dhe vendbanimi rural apo urban. Me dakordësinë e të rinjve fokus grupet u regjistruan me audio me qëllim zbardhjen e të dhënave të mbledhura nga diskutimi. Të dhënat u zbardhën dhe u grupuan sipas seksioneve të analizës së të dhënave. Gjatë intervistave që u zhvilluan me fokus grupet, pjesëmarrësve iu drejtuan një sërë pyetjesh të cilat ndiqnin logjikën e pyetësorit si: 1) qëndrimet dhe perceptimet e tyre ndaj dhunës në familje dhe në marrëdhëniet intime; 2) përvojën e tyre me dhunën gjatë jetës së tyre dhe të shokëve/shoqeve; 3) pikëpamjet e pranueshmërisë së sjelljeve të dhunshme mes partnerëve apo në familje; 4) qëndrimet dhe përvojat e tyre me përdorimin e substancave të ndryshme si duhani, alkooli, apo droga; 5) si dhe pikëpamjet e tyre ndaj aspekteve të ndryshme të dhunës në marrëdhëniet intime.

### ***Kufizime të studimit***

Ky studim ka edhe disa kufizime. Para së gjithash, të dhënat janë të vetë-raportuara, dhe si të tilla, shkalla e nën-raportimit apo mbi-raportimit në lidhje me temat e trajtuara në anketë nuk mund të përcaktohet me saktësi, edhe pse të dhënat përgjatë këtij raporti kanë qenë konsistente. Gjithashtu, në këtë studim janë përdorur të dhëna të mbledhura vetëm nga adoleshentët dhe nuk janë mbledhur të dhëna rreth këtij fenomeni edhe nga prindërit/kujdestarët apo mësuesit të cilët shpesh herë janë në dijeni të rasteve të viktimizimit apo ushtrimit të dhunës me partner intimë. Më tej, rezultatet e këtij studimi përfaqësojnë të rinjtë/rejat 16 vjeç -18 vjeç+ që frekuentojnë shkollën e mesme publike, e për rrjedhojë nuk përfaqësojnë të gjithë të rinjtë/rejat e Shqipërisë. Sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT, në vitin shkollor 2017-2018, shkalla e pjesëmarrjes së nxënësve në arsimin e mesëm publik është 88 përqind. Ndërkohë që të dhënat nga studime të tjera jashtë Shqipërisë, kanë treguar që të rinjtë/rejat që nuk ndjekin shkollën, janë më të prirur/a drejt sjelljeve të dhunshme, apo te rrezikshme, se sa ata që e frekuentojnë shkollën. Në studim ka një përfaqësim shumë të ulët të adoleshentëve që i përkasin komuniteteve të tjera si p.sh. Komuniteti Rom apo Egjyptian (2 përqind e pjesëmarrësve).

# Rishikim literature

## Dhuna në marrëdhëniet intime

Termi *Dhunë në Marrëdhëniet Intime (DhMI)*, përshkruan kontrollin e një personi ndaj një personi tjetër, përmes abuzimit fizik, psikologjik, seksual, financiar dhe/ose dixhital, që ka pasoja afatgjata shëndetësore, psikologjike, arsimore dhe ekonomike për personat e mbijetuar. Hulumtime të ndryshme mbi fenomenin, tregojnë se DhMI ka kosto të konsiderueshme sociale dhe ekonomike për gjithë shoqërinë (Hess dhe Del Rosario, 2018). Kosto të tilla lidhen me shëndetin, produktivitetin e humbur dhe kosto të drejtësisë penale (Hess dhe Del Rosario, 2018). Përveç këtyre kostove shpeshherë viktimat e DhMI humbasin mundësitë për t'u arsimuar më mirë, për të punuar dhe/apo humbasin kontrollin mbi zgjedhjen dhe kohën e lindjes së fëmijës (Hess dhe Del Rosario, 2018).

Abuzimi në marrëdhëniet intime është i shumëfishtë dhe ndaj është i domosdoshëm hartimi i programeve dhe politikave kundër DhMI që rrisin sigurinë shoqërore dhe ekonomike të njerëzve. DhMI është një çështje e të drejtave të njeriut dhe shumë serioze për shëndetin publik të njerëzve. DhMI shpesh përfshin edhe fëmijët. Bazuar në raportimet e grave të dhunuara shqiptare, në një studim kombëtar (Haarr, 2013) rreth 87 përqind e tyre raportuan se fëmijët e tyre kishin qenë dëshmitarë të dhunës në familje dhe rreth 43 përqind raportuan se dhuna në familje kishte shkaktuar probleme në të nxënësit e fëmijëve. Më tej, në të njëjtin studim u raportua nga vetë gratë se 31 përqind e fëmijëve të tyre jetonte me frikë, 19.2% raportuan se fëmijët e tyre ishin dëmtuar apo plagosur për shkak të dhunës në familje dhe 5.5% raportuan se fëmijët e tyre ishin larguar nga familja për të jetuar te të afërmit (Haarr, 2013).

Në përgjithësi ka shoqëri që e pranojnë dhe justifikojnë DhMI dhe fatkeqësisht Shqipëria hyn në këto vende. Një analizë gjinore ekologjike në 49 vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme, përfshirë Shqipërinë, DhMI justifikohet dhe pranohet në situata të caktuara nga 36 përqind e njerëzve (Sardinha dhe Catalán, 2018). Siç përmendëm më lart, përveç pasojave të ndryshme tek viktimat e DhMI, ky fenomen prek edhe fëmijët e tyre nëse kanë. Këta të fundit, nëse janë dëshmitarë të dhunës në familje janë në rrezik të ushtrojnë dhunë në të ardhmen.

Në një studim të kryer nga Forke, e të tjerë, (2018) rezulton se adoleshentët dëshmitarë të dhunës në familje, gjatë marrëdhënies intime, shfaqin dhunë në rastet e djemve dhe një kombinim të dhunës apo viktimizimit tek vajzat. Në përgjithësi studimi vërteton se rreziku për të qenë dhunues ose viktimë e dhunës gjatë adoleshencës, rritet nëse ke qenë dëshmitar i dhunës në familje. Raporti i hartuar nga IDRA dhe UN women (2018) informon se 44 përqind e pjesëmarrësve në studim pohojnë se kanë një mike ose një pjesëtare të familjes e cila është ngacmuar ose dhunuar seksualisht.

Dhuna me bazë gjinore ka një sërë pasojash negative duke filluar nga ato fizike deri tek ato psikologjike e emocionale të viktimave dhe dhunuesve (Caldwell, Swan dhe Woodbrown, 2012; Cornelius e të tjerë, 2009; Foshee dhe Reyes, 2012). Sipas këtyre studiuesve, DhMI fillon në moshë të hershme, shpesh në marrëdhënien e parë intime dhe ndodh pa përjashtim midis të gjitha grupeve social-ekonomike, fetare dhe kulturore. DhMI është konceptuar gjerësisht duke përfshirë forma të abuzimit fizik, seksual, emocional si dhe përndjekje nga partneri intim (Breiding, 2014, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), 2012). Qendra Ndërkombëtare e Kontrollit dhe Parandalimit të Dëmtimeve (QNKPD, 2003) si dhe OBSH (2002) dalin në përfundimin se DhMI është një nga shkaktarët kryesorë të plagosjeve dhe shumë dëmtimeve fizike dhe emocionale që shkaktohen midis partnerëve të moshave të ndryshme. OBSH (2017) e ka deklaruar dhunën ndaj grave si një problem global shëndetësor me përmasa epidemike. Literatura ekzistuese sugjeron se forma të ndryshme të dhunës shpeshherë bashkë-ekzistojnë: dhuna fizike midis partnerëve intimë shpeshherë shoqërohet me dhunë seksuale apo zakonisht shoqërohet me abuzim emocional.

Në të shumtën e rasteve, dhuna ndaj grave ushtrohet nga një partner intim. Është fakt që nga të gjitha gratë e vrara në vite të ndryshme në Shqipëri, më shumë se gjysma kanë vdekur në duart e një partneri ose të një pjesëtari të familjes. Kjo do të thotë që kërcënimi më i madh ndaj jetës së grave janë burrat, madje shpesh, burrat që ato duan (Mlambo-Ngcuka, 2014). Për të kuptuar shkaqet dhe faktorët e rrezikut për DhMI, ekzistojnë një sërë teorish dhe modelesh. Studiuesit kanë identifikuar dhjetra faktorë risku që degjenerojnë në DhMI, (Finkel dhe Eckhardt, 2013), por ato kanë qenë më pak të suksesshme në identifikimin e proceseve përmes të cilave këta faktorë të rrezikut nxisin DhMI. Në 10 vjeçarin e fundit janë shtuar shumë studimet empirike në lidhje me DhMI dhe modele teorike janë zhvilluar në këto studime. Një model teorik që ndihmon shqyrtimin e këtij procesi interaktiv është modeli sipas teorisë I<sup>3</sup> (Finkel, 2008). Ky model pohon se ka tre procese kryesore që ndërveprojnë së bashku dhe që nxisin DhMI (*impelling force* – forca nxitëse, *inhibiting force* – forca frenuese dhe *instigating trigger* - sulmi). Prezenca e këtyre tre faktorëve çon drejt ushtrimit të DHMI-së. Nga perspektiva social-kulturore, DhMI është një mënyrë e shfaqjes së



agresivitetit nga burrat për të nxitur frikë dhe për të zbatuar një rend shoqëror patriarkal në të gjitha institucionet e rëndësishme sociale, përfshirë vendin e punës, kujdesin shëndetësor, sistemin e drejtësisë dhe familjen. Vajzat dhe grate në Shqipëri jetojnë nën efektin e dhunës në familje, normave e paragjykimeve të vendosura për to (CEDAW, 2016).

Në disa krahina në Shqipëri, kodi i sjelljes lejon faljen e vrasjeve të grave e vajzave në emër të të ashtuquajturit 'nder'. Në vlerësimin në lidhje me dhunën ndaj grave, publikuar nga GREVIO në vitin 2017, u theksua se opinionit publik në Shqipëri i mungon dimensionin gjinor në lidhje me dhunën ndaj grave e vajzave sepse në përgjithësi, përfshirë ekspertë të ndryshëm tentojnë ta shohin dhunën si një nënprodukt të zhvillimit të ulët socio – ekonomik (GREVIO, 2017), duke shpërfillur dëshmitë e shumta se pozita e grave në shoqëri dhe dhuna ndaj saj preket nga një kombinim politik, kulturor, social, fetar, ideologjik dhe mjedisor, dhe nuk ndodh vetëm për shkak të faktorëve ekonomikë. I njëjti raport GREVIO (2017) informon se në Shqipëri ka një tendencë, për të promovuar faljen nën pretekstin e ruajtjes së vlerave tradicionale të familjes. Edhe më keq, në Shqipëri ka një tendencë që shfaqet, për shembull, në veprimet e zyrtarëve publikë në zbatimin e ligjit dhe veprimet e gjyqësorit që promovojnë ndërmyjetësimin jashtë çdo kuadri ligjor dhe pa marrë në konsideratë sigurinë e viktimave (GREVIO, 2017).

Nga ana tjetër një studim i realizuar për sigurinë në qytete thekson se, pavarësisht përpjekjeve të shumta të palëve të ndryshme për të krijuar mekanizmat dhe instrumentet e raportimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave, ekziston një bindje e përgjithshme se gratë dhe vajzat nuk i bëjnë publike episodet e dhunshme dhe e durojnë dhunën me qëllimin që ta mbajnë familjen të bashkuar (IDRA and UN women, 2018).

Gratë dhe vajzat vetëbesojnë, në një masë të madhe, se ato duhet të tolerojnë dhunën për të mbajtur së bashku familjen. Rreth 30 përqind e grave shqiptare bien dakort që burri është i justifikuar që të ushtrojë dhunë ndaj grave nëse ka të paktën një arsye (UNICEF, 2017). I njëjti raport (UNICEF, 2017) informon se në Shqipëri, 31 përqind e grave që kishin përjetuar ndonjëherë ndonjë formë të DhMI raportuan se fëmijët e tyre jetonin në frikë, dhe 19 përqind raportuan se fëmijët e tyre ishin gjithashtu të lënduar apo plagosur nga dhunuesi (Haarr, 2013).

Shumë studiues mendojnë se seksizmi dhe pabarazia gjinore në një shoqëri patriarkale, janë ndër shkaqet kryesore të DhMI (Bell dhe Naugle, 2008). Rolet gjinore të përcaktuara nga shoqëria u mësohen individëve gjatë fëmijërisë dhe këto mendohet se iu japin burrave pushtetin mbi gratë (Dobash dhe Dobash, 1977). Ndarja e pabarabartë e roleve gjinore çon në viktimizimin dhe ushtrimin e dhunës ndaj grave nga burrat. Normat e viktimizimit të grave janë më të larta në vendet ku gjenden qëndrime të forta seksiste. Gjetjet e shumë

studimeve që kanë kontribuar në formimin e teorisë feministe tregojnë se familjet çënohen më shumë nga DhMI kur burrat mbajnë qëndrime tradicionale të rolit seksual dhe kur ka mospërputhje të mëdha midis bashkëshortëve rreth pranimin të vlerave patriarkale. Sipas Straus (1976, 1977), argumentohet se rrënjët e dhunës nuk janë vetëm tek kultura por edhe tek struktura e familjes. *Konflikti familjar, pranimi i dhunës si një fenomen social dhe pabarazia gjinore hipotetizohet të ndërveprojnë dhe të çojnë në ushtrimin dhe pranimin e DhMI*, e cila më pas ndikon në vazhdimin e dhunës në familje. Përdorimi i dhunës si justifikim për të zgjidhur konfliktet e familjes mendohet se mësohet që në fëmijëri duke qenë vetë individ dëshmitar apo viktimë e dhunës. Kjo teori sugjeron gjithashtu se mosbalancimi i pushtetit midis bashkëshortëve mund të rrisë tensionin brenda familjes, duke rritur kështu rrezikun e agresivitetit të partnerit intim. Studime të tjera tregojnë se familjet që përjetojnë shumë konflikt, kanë nivele të larta të stresit apo që vijnë nga një status i ulët social-ekonomik, çënohen më shumë nga DhMI (Johnson dhe Leone, 2005; Straus, 2017).

Nga perspektiva individuale, studiuesit e shpjegojnë DhMI-në nëpërmjet teorisë së të mësuarit social, modelit të situatës apo teorive të personalitetit. Mbështetësit e teorisë së të mësuarit social supozojnë se DhMI është mësuar fillimisht përmes modelimit gjatë fëmijërisë. Sipas Lewis & Fremouw (2001) kjo më pas çon në zhvillimin e tolerancës apo pranimin e dhunës në familje. DhMI vazhdon nëse ajo ka një qëllim të caktuar apo është përforcuar më parë. Prandaj, nëse një partner abuzues sheh rezultate pozitive nga sjellja e dhunshme, ai pret që e njëjta sjellje të çojë në rezultate të njëjta, rrjedhimisht dhuna do të vazhdojë. Kjo teori gjithashtu thekson se nuk kërkohet përforcim i drejtpërdrejtë i sjelljes së dhunshme për të shfaqur atë sjellje. Përkundrazi, thjesht duke qenë dëshmitar i sjelljeve të dhunshme mund të jetë e mjaftueshme për të përcaktuar nëse një individ do të përfshihet në episode të dhunshme në të ardhmen.

Riggs dhe O'Leary (1989, 1996) zhvilluan një model për të shpjeguar DhMI-në. Ky model përbëhet nga dy komponentë: 1) faktorët e formimit dhe 2) faktorët e situatës. *Faktorët e formimit* përfshijnë përvoja si dëshmitarë apo përjetues të abuzimit, karakteristikat e personalitetit agresiv, përdorimin paraprak të agresivitetit, psikopatologjinë dhe pranimin shoqëror të agresivitetit si një mjet për të zgjidhur konfliktin. Komponenti i dytë i referohet *faktorëve të situatës* që krijojnë edhe terrenin për shfaqjen e dhunës. Konflikti ndërpersonal, përdorimi i substancave, kënaqësia nga marrëdhëniet, nivelet e intimitetit, aftësitë për zgjidhjen e problemeve, pritshmëritë personale nga rezultatet e dhunës dhe stilet e komunikimit janë të gjitha faktorë të situatës që mendohet të jenë të lidhura me fillimin e një episodi të dhunshëm. Riggs dhe O'Leary (1989, 1996) propozojnë që *bashkëveprimi midis*

*këtyre dy komponentëve mund të ndikojë në intensitetin e konfliktit në çift, dhe gjithashtu, është një parashikues me rëndësi për të vlerësuar nëse do të ndodhë ose jo dhuna fizike.*

Së fundmi, janë teoritë e personalitetit ato që mund të shpjegojnë psikopatologjinë dhe karakteristikat e personalitetit të një individi që e bëjnë atë të dhunshëm. Këto teori theksojnë rolin e atashimit, përvojat e fëmijërisë së hershme dhe impulsivitetin mbi ushtrimin e DhMI-së (Dutton, 1995; Holtzworth-Munroe dhe Stuart, 1994). Sipas këtyre teorive, tendenca për të ushtruar DhMI në moshën e rritur rrjedh nga atashimi i pasigurt dhe turpi që zhvillohet gjatë fëmijërisë së hershme dhe më pas gjatë adoleshencës. Individët me këtë stil atashimi karakterizohen nga dëshira për të pasur një marrëdhënie të ngushtë shoqërore, por ndërkohë përjetojnë edhe frikë nga refuzimi apo mosbesimi ndaj të tjerëve, duke rezultuar në pakënaqësitë në marrëdhëniet intime. Këto teori shpjegojnë sesi kombinime të faktorëve të ndryshëm, siç janë faktorët gjenetikë apo përvojat me bashkëmoshatarët ndikojnë në formimin e një individi të dhunshëm i cili karakterizohet nga një nga tipet e ndryshme të personalitetit ku përmenden, të dhunshëm vetëm në familje, antisocialë dhe të dhunshëm (Bell dhe Naugle, 2008).

## **Dhuna në marrëdhëniet intime midis adoleshentëve**

Marrëdhëniet intime mes adoleshentëve kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve që kur adoleshenca u pranua si një fazë zhvillimi e ndarë nga fëmijëria dhe mosha e rritur. Por ajo çfarë studiuesit nuk i kushtuan shumë rëndësi ishte dhuna që shoqërohej me intimitetin gjatë adoleshencës. Madje, kjo dhunë nuk ekzistonte vetëm në çiftet e martuara siç mendohej më parë, por ajo ekzistonte në çdo çift që ka një marrëdhënie intime (O'Keeffe, Brockopp, dhe Chew, 1986). Sidomos në dekadën e fundit, ky fenomen është konsideruar si një problem social i hapur për ta eksploruar, studiuar dhe adresuar.

Studimi i parë që është bërë nga Henton dhe Cate (1983) vetëm në një shkollë pasi 6 shkolla të tjera refuzuan të bëhen pjesë e këtij studimi në Kaliforni të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) mbi dhunën në marrëdhëniet intime midis adoleshentëve, tregon se 12 përqind e pjesëmarrësve kishin përjetuar dhunë në një nga marrëdhëniet intime (O'Keeffe, Brockopp, dhe Chew, 1986). Studime të tjera tregojnë se dhuna në marrëdhëniet intime midis nxënësve të shkollave të mesme është përhapur më shumë se sa besohej dhe se ajo ka pasoja të rënda zhvillimore. Adoleshentët çenohen më shumë nga kjo formë e dhunës e cila lë pasoja të mëdha në dy aspekte të zhvillimit të shëndetshëm social: 1) formimi

i marrëdhënieve të shëndetshme, dhe 2) zhvillimi i intimitetit ndërpersonal (Powers dhe Kerman, 2006).

Sipas vlerësimeve të bëra nga OBSH (2017) 35% e grave në të gjithë botën kanë përjetuar dhunë fizike dhe ose seksuale nga një partner intim gjatë jetës së tyre. *Studimet me adoleshentët tregojnë që një në dhjetë adoleshentë janë viktimë që përjetojnë dhunë fizike, seksuale ose psikologjike në një marrëdhënie me partner intim* (Fry e të tjerë, 2013; Hickman e të tjerë, 2004; Mulford dhe Giordano, 2008).

Kjo lloj dhune në shkollat e mesme varion nga 9 përqind deri në 57 përqind (O'Keefe, 2005). Sipas Powers dhe Kerman (2006), mbështetur në të dhëna nga qendrat e kontrollit të sëmundjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (2000) nga përdorimi i kampioneve kombëtare raportojnë se mesatarisht, shfaqja e DhMI për nxënësit e shkollave të mesme dhe universiteteve në SHBA është 22 përqind dhe 32 përqind respektivisht. Në Shqipëri sipas raportit të IDRA dhe UN women (2018) 38 përqind e të anketuarve kanë pohuar që kanë qenë të rrezikuar ose të ekspozuar ndaj ngacmimeve dhe dhunës seksuale para ose pas moshës 15-vjeçare (disa i kanë përjetuar të dyja). Dhuna në marrëdhëniet intime mes adoleshentëve përfshin çdo lloj sjelljeje të shfaqur nga e dashura apo i dashuri me qëllim manipulimin, ushtrimin e forcës dhe kontrollit mbi tjetrin, për të bërë një person të ndjehet keq për veten e tij/saj apo për të bërë një person të ndjehet i frikësuar për sigurinë e tij (Network ODV, 2013). Kjo lloj dhune ka një sërë pasojash në shëndetin e tyre, duke rritur kështu rrezikun e depresionit dhe vetëvrasjes (Banyard dhe Cross, 2008; Exner-Cortens, Eckenrode, dhe Rothman, 2013), vetëbesimit të ulët (O'Keefe 1997), arritjeve të ulëta akademike (Smith, White, & Holland, 2003), çrregullimeve të të ngrënit, çrregullimit të stresit post-traumatik, ankthit, abuzimit me substancat, sjelljeve të rrezikshme seksuale (Temple dhe Freeman, 2011), si dhe mirëqënie të varfër emocionale apo shtatëzani të padëshiruar (Cornelius, Shorey, dhe Kunde, 2009; Fincham e të tjerë, 2008). *Në Shqipëri, deri më sot nuk ekziston asnjë studim i mirëfilltë rreth dhunës në marrëdhëniet intime në adoleshencë.*

Ndër faktorët kryesorë të rrezikshëm që bëhen shkak për shfaqjen e këtyre sjelljeve janë përdorimi i substancave si duhani, alkooli apo droga si dhe ekspozimi i adoleshentëve ndaj dhunës në familje apo në komunitet. Shumë studime tregojnë se ka një korrelacion domethënës mes përdorimit të substancave dhe sjelljeve të dhunshme ku si djemtë ashtu edhe vajzat të cilët kanë pasur episode të përdorimit të alkoolit, duhanit apo lëndëve narkotike, kanë qenë më të predispozuar për t'u viktimizuar apo për të ushtruar dhunë (Mcdonnell e të tjerë, 2010; Rothman e të tjerë, 2012; dhe Temple dhe Freeman, 2011). Ndërkohë, ekspozimi i

adoleshentëve sidomos ndaj dhunës në familje konsiderohet si një parashikues i fortë i DhMI-së (Jouriles e të tjerë, 2012; dhe Wincentak e të tjerë, 2017). Gjithashtu, siguria në komunitet është një faktor që ndikon në parandalimin e këtyre sjelljeve. Sipas disa studimeve, zonat me nivel të ulët ekonomik apo me paqëndrueshmëri rezidenciale, kanë nivel shumë të lartë të dhunës dhe krimit (Buka, 2001; dhe Molnar e të tjerë, 2004).

## Siguria në komunitet

Studimet e bëra me adolehentë dhe të rinj tregojnë se siguria në lagje është një nga faktorët mjedisorë që ndikon në nivelin e krimit apo të dhunës. Lagjja ku jetojnë banorët është përcaktuese e statusit ekonomik, politik dhe social të individit. Ajo gjithashtu ndikon përtej familjes në shëndetin dhe sjelljen e banorëve (Ben-Arieh, McDonell, dhe Attar-Schwartz, 2009; McDonell, 2007). Sipas disa studimeve, së fundmi, me rënien e ekonomisë globale, lagje të shumta janë varfëruar, ku shumë nga këto cilësohen si “zona urbane të luftës” ose “mjedise sociale toksike” pasi atyre iu mungojnë mundësitë dhe kanë akses në armë, trafikim dhe nivel të lartë të dhunës në komunitet. Sipas Buka dhe kolegëve të tij (2001), të rinjtë që jetojnë në zona urbane përjetojnë nivele të larta të dhunës në komunitet, sidomos në ato lagje me nivel të ulët ekonomik, ku shpeshherë ndodhin edhe vrasje (Molnar e të tjerë, 2004).

Teoria e disorganizimit social sugjeron se faktorët kontekstualë që parashikojnë DhMI-në ndikojnë në shfaqjen e krimit apo viktimizimit. Të një rëndësie të veçantë janë faktorët përbërës të lagjes të cilët kanë lidhje me statusin e ulët ekonomik, heterogjenitetin etnik, dhe paqëndrueshmërinë rezidenciale. Sipas kësaj teorie, lagjet e karakterizuara nga shumë disavantazhe, heterogjenitet etnik, dhe paqëndrueshmëri rezidenciale kanë nivel më të lartë krimi, sepse kanë kapacitete të vogla për të ushtruar kontroll social formal dhe joformal. Kjo teori thekson se proceset sociale që ekzistojnë mes banorëve të lagjes mund të ndikojnë në lidhjen mes faktorëve strukturorë dhe krimit. Këta faktorë janë efikasiteti kolektiv, lidhjet shoqërore dhe normat kulturore të cilat nëse janë prezente në një komunitet, niveli i krimit është më i ulët pavarësisht kushteve ekonomike duke përfshirë edhe ndikimin ndaj dhunës mes partnerëve (Pinchevsky dhe Wright, 2012). Gjithashtu, lagjet që kanë banorë me nivel të lartë të përgjegjësisë sociale dhe besimit kanë nivel më të ulët të krimit si dhuna (Lynch, 2002).

## Këndvështrimet e adoleshentëve mbi dhunën dhe eksperiencat e tyre me dhunën

Qëndrimet e adoleshentëve ndaj dhunës ndikojnë në viktimizimin dhe ushtrimin e DhMI-së. Shumë studime tregojnë se një rëndësi të veçantë në literaturën rreth këtij fenomeni zënë këndvështrimet dhe besimet që krijojnë adoleshentët rreth dhunës ku shpeshherë e shohin atë si normë dhe të pranueshme (Reed e të tjerë, 2011; Shamir e të tjerë, 2001; dhe Temple e të tjerë, 2013). Nëse të rinjtë mendojnë se dhuna nuk ka justifikim, kjo e ul rrezikun e shfaqjes së DhMI-së (McDonell e të tjerë, 2010). Sipas Riggs and O'Leary (1989, 1996), adoleshentët të cilët kanë qenë të ekspozuar ndaj sjelljeve agresive të shfaqura nga prindërit, i konsiderojnë këto sjellje si më të pranueshme dhe të justifikueshme dhe rrjedhimisht sillen në mënyrë më abuzive gjatë konflikteve që lindin me një partner romantik. Ky lloj këndvështrimi ndaj DhMI-së është një nga parashikuesit më të fortë të dhunës në marrëdhëniet intime (Kinsfogel dhe Grych, 2004).

Studimet tregojnë se si gratë ashtu edhe burrat rezultojnë të jenë viktimat të dhunës me partner intimë (Brooks-Russell e të tjerë, 2013). Por sidomos vajzat e moshës 16-24 vjeç çënohen më shumë nga DhMI. Viktimizimi i vajzave gjithashtu shoqërohet me një sërë faktorësh rreziku si: përdorimi i alkoolit, përdorimi i marjuanës, apo edhe kryerja e marrëdhënieve seksuale në moshë të re (Wekerle e të tjerë, 2009). Gratë gjithashtu vuajnë më shumë pasoja negative të dhunës sidomos asaj fizike (O'Keefe, 2005). Sipas disa studimeve përdorimi i dhunës reciproke përfshin si gratë ashtu edhe burrat. Adoleshentët djem shkaktajnë më shumë dëmtime ndaj viktimave vajza. Makepeace (1987) raporton se duke i krahasuar me djemtë, vajzat kanë më shumë gjasa të përjetojnë lëndime dhe të kërkojnë trajtim mjekësor si pasojë e DhMI-së. Megjithatë, adoleshentet vajza ushtrojnë më shumë dhunë fizike sesa adoleshentët djem, me normat e ushtrimit të dhunës nga vajzat duke filluar nga 28 përqind në 33 përqind në krahasim me normat e ushtrimit të dhunës nga djemtë duke filluar nga 11 përqind në 20 përqind (Powers dhe Kerman, 2006).

Sipas një studimi afatgjatë në lidhje me shëndetin e adoleshentëve, 2-3 në 10 adoleshentë raportojnë se kanë qenë të abuzuar verbalisht dhe psikologjikisht një vit më parë. Ndërsa, sipas Coker dhe kolegëve (2000), në një studim me adoleshentë në Karolinën e Jugut, rreth 8 përqind e adoleshentëve raportojnë se kishin ushtruar dhunë fizike ndaj një partneri intim. Por, normat e raportuara të viktimizimit kundrejt ushtrimit të dhunës ishin të njëjta, si për djemtë ashtu edhe për vajzat. Megjithatë, përsa i përket dhunës së ashpër me partner intim duke përfshirë dhunën seksuale dhe fizike, në të shumtën e rasteve vajzat ishin viktimat (Mulford dhe Giordano, 2008). Prandaj, *përjetimi i dhunës në marrëdhëniet intime gjatë*

*adoleshencës mund të rrisë shpeshtësinë e sjelljeve anti-sociale në mënyrë të veçantë tek djemtë dhe sjelljeve viktimizuese tek vajzat.*

## **Alkooli, duhani e droga dhe marrëdhënia e këtyre substancave me dhunën në marrëdhëniet intime**

Sipas të dhënave nga Instituti I Shëndetit Publik (IShP), konsumimi i alkoolit, duhanit dhe substancave të tjera ndikon në përditshmërinë e të rinjve në Shqipëri (2013). Fillimi i përdorimit të substancave që në moshë të hershme mund të kthehet në një faktor që ndikon në shfaqjen e problemeve të tjera gjatë adoleshencës dhe për më tepër mund të bëhet shkak për të vazhduar përdorimin e tyre dhe krijimin e varësisë ndaj tyre si të rritur (IShP, 2013). Konsumimi i vazhdueshëm i tyre lidhet edhe me dhunën në familje dhe atë në çift. Shumë studime me natyrë vëzhguese apo ndër-seksionale që janë bërë më parë kryesisht në SHBA, tregojnë se ka një korrelacion të ngushtë mes përdorimit të substancave dhe viktimizimit dhe ushtrimit të DhMI (Temple dhe Freeman, 2011). McDonnell dhe të tjerë (2010) në një studim me adoleshentë për dhunën në marrëdhëniet intime, konfirmuan faktin se përdorimi i alkoolit ishte një nga faktorët me ndikimin më të lartë në shfaqjen e sjelljeve të rrezikshme mes adoleshentëve përfshirë DhMI. Përdorimi i alkoolit gjithashtu rrit shfaqjen e sjelljeve të rrezikshme duke qenë se adoleshentët mund të ndërmarrin vendime dhe kryejnë veprime, të cilat nuk do t'i bënin në rast se nuk do të kishin konsumuar alkool. Në Shqipëri, burrat dhe djemtë që janë të përfshirë në rrjetet e trafikimit të drogës apo janë konsumatorë të substancave narkotike janë identifikuar si një problem i përbashkët që ndikon në ndjenjën e sigurisë personale të grave dhe vajzave (IDRA dhe UN women, 2018).

Studimet tregojnë që të rinjtë, si djemtë ashtu edhe vajzat, të cilët kanë pasur episode të rënda të përdorimit të alkoolit, duhanit apo marjuanës, kanë qenë më të predispozuar për të ushtruar DhMI. Rothman dhe kolegët e tij (2012), në një analizë të 28 studimeve të bëra para vitit 2011, dolën në përfundimin se sidomos përdorimi i alkoolit, rrit në mënyrë domethënëse, rrezikun e DhMI-së midis adoleshentëve (Temple e të tjerë, 2013) dhe ndikon në krijimin e një konteksti më vulnerabël për të miturin duke rritur mundësinë e të qenurit abuzues apo edhe viktimë e dhunës në marrëdhëniet intime (Fry e të tjerë, 2014). Megjithatë, studimet afatgjata tregojnë se përdorimi i substancave nga ana e vajzave ndikon në shfaqjen e DhMI-së në një periudhë më të vonshme, por që ky korrelacion dobësohet me kalimin e vajzave adoleshente në shkollë të mesme. Sidomos kur të rinjtë kalojnë në universitet, korrelacioni mes përdorimit të substancave dhe DhMI-së dobësohet

ndjeshëm. Sipas raportit të ISHP (2013), me rritjen në moshë rritet edhe përqindja e të rinjve që përdorin substanca, ku djemtë më shpesh se vajzat përdorin substancat dhe diferenca rritet me rritjen në moshë.

Edhe pse nuk është vetëm alkooli apo abuzimi me substanca të tjera që shkakton dhunën, studimet tregojnë se alkooli sidomos, ndikon në shpeshtësinë e sjelljes së dhunshme dhe në ashpërsinë e saj. Sipas studimit të INSTAT (2013) për dhunën në familje u vu re se gratë, bashkëshortët/partnerët e të cilave konsumonin alkool kishin pothuaj tri herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë fizike, dhe gjashtë herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime, në krahasim me gratë, bashkëshortët/partnerët e të cilave nuk pinin alkool. Kështu, Reyes dhe kolegët e tij (2012) dolën në përfundimin se korrelacioni i konsumimit të substancave me DhMI ndikohej nga përvojat e adoleshentëve me dhunën në familje apo të pasurit miq të përfshirë në DhMI.

## **Familja dhe miqtë në lidhje me dhunën në DhMI**

Adoleshentët shpesh herë hezitojnë të ndajnë përvojat e tyre me të rriturit në lidhje me DhMI dhe preferojnë të flasin më shumë me miqtë e tyre. Edhe pse të rinjtë e përfshirë në DhMI, kanë pak miq ku mund të mbështeten (Ekerle e të tjerë, 2009), ata preferojnë të flasin për dhunën në marrëdhëniet intime me ata pak miq, sesa të kërkojnë ndihmën e familjes (Black e të tjerë, 2008). Mungesa e mbështetjes sociale si nga familja ashtu edhe nga miqtë e të rinjve, e bën më të vështirë përballjen e tyre me këtë situatë. Megjithatë, Incentak, Connolly dhe Card (2017) në një analizë të 96 studimeve të lidhura me dhunën në marrëdhëniet intime mes adoleshentëve dhe 31 studimeve për dhunën seksuale mes tyre arritën në përfundimin se familja nuk ishte një faktor që ndikonte në shfaqjen e sjelljeve agresive dhe viktimizimin e adoleshentëve në marrëdhëniet intime, por shumë ndikim sillnin niveli i monitorimit të prindërve dhe ekspozimi i adoleshentëve ndaj dhunës në marrëdhëniet mes prindërve. Të rinjtë që janë rritur në një familje të dhunshme supozohet të jenë më të prirur për të ushtruar DhMI. Edhe pse studimet empirike vazhdimisht e mbështesin idenë se dhuna në familje është ndër parashikuesit kryesorë të DhMI, akoma nuk dihet sesi ekspozimi ndaj dhunës në familje nxit DhMI. Kërkimet e lidhin dhunën në familje me DhMI-në, duke konsideruar dhunën në familje si dhuna intime mes prindërve apo dhuna prindërore ndaj fëmijëve të cilat shfaqen njëkohësisht në familje. Nëse një fëmijë duke qenë i ekspozuar ndaj dhunës në familje arrin në përfundimin se dhuna është e justifikueshme në disa rrethana dhe marrëdhënie të caktuara, ai fëmijë do të ketë një qëndrim më pranues ndaj DhMI-së. Duke e



parë në një kontekst të gjerë, dhuna në familje ka një korrelacion domethënës me DhMI-në (Jouriles e të tjerë, 2012).

Adoleshentët kalojnë një pjesë të mirë të kohës së tyre me bashkëmoshatarët dhe ndikimi i tyre në stilin e jetesës është tejet i rëndësishëm. Studiues të ndryshëm në fushën e psikologjisë së zhvillimit theksojnë se bashkëmoshatarët kthehen në qendrën e influencës duke reduktuar disi ndikimin e prindërve. Teoria e modelit socio-ekologjik e përpunuar nga Bronfenbrenner (1979) është një bazë me rëndësi për të kuptuar faktin se adoleshentët janë lehtësisht të ndikueshëm nga mjedisi social ku ata jetojnë dhe individët që ndodhen pranë tyre kanë shumë ndikim në sjelljen e tyre. Ata janë në procesin e ndërtimit të identitetit, dhe kanë nevojë të vazhdueshme për modele dhe për pranim social. Në këtë kontekst, grupi i bashkëmoshatarëve mund të ndikojë kohën e krijimit të marrëdhënieve të para, vetë krijimin e marrëdhënieve, apo cilësinë e marrëdhënies intime. Bashkëmoshatarët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e konflikteve brenda marrëdhënieve dhe ofrimin e mbështetjes (Garthe, Sullivan dhe McDonnell, 2017).

Janë të pakta studimet që analizojnë marrëdhënien ndërmjet faktorëve komunitarë dhe DhMI-së mes adoleshentëve. Gjithsesi të dhënat ekzistuese tregojnë lidhje të qarta mes nivelit të dhunës në komunitet dhe nivelit të dhunës në marrëdhëniet intime mes adoleshentëve (Vézina dhe Hébert, 2007). McDonnell dhe të tjerë (2010) arritën në konkluzionin se adoleshentët që kishin në rrethin e tyre miq/mike viktime të dhunës ose dhunues, kishin më shumë shanse të ishin viktime të dhunës apo të dhunonin dikë tjetër. Vajzat që kishin miq/mike viktime kishin më shumë shanse të përjetonin përvoja dhune krahasuar me djemtë që kishin miq/mike dhunues. Ata vunë re gjithashtu se në kampionin e tyre vajzat më shpesh se djemtë raportonin të kishin qenë viktime të formave të dhunës në marrëdhëniet intime.

Fry e të tjerë (2014) vërejtën se më pak se gjysma e adoleshentëve viktime të dhunës në marrëdhëniet intime kërkonin ndihmë. Pjesa dërrmuese e tyre e kërkonin ndihmën në rrjetin joformal mbështetës, kryesisht tek miqtë dhe më pas tek familja. Hébert e të tjerë (2014) në një studim me adoleshentë (14-18 vjeç) në Kanada arritën në konkluzionin se bashkëmoshatarët ishin burimi kryesor i mbështetjes për të rinjtë viktime të dhunës në marrëdhëniet intime. Më tej, ata vunë re disa diferenca gjinore ku vajzat sipas tyre ishin më të prirura të kërkonin ndihmë krahasuar me djemtë, por ishin edhe më të prirura të ofronin ndihmë kur ishin dëshmitare të dhunës në marrëdhëniet intime krahasuar me djemtë. Ata vunë re gjithashtu se të rinjtë që ishin viktime të dhunës në kontekste të tjera ishin më pak të prirur të kërkonin ndihmë në rastet kur dhunoheshin edhe nga partnerët intimë. Në Shqipëri

nga 286 raste të evidentuara të ngacmimit dhe dhunës seksuale, vetëm 16 përqind kanë kërkuar ndihmë (IDRA dhe UN women, 2018). Shumica prej tyre kanë kërkuar ndihmë nga të afërmit dhe miqtë e tyre, ndërsa një numër shumë i kufizuar i është drejtuar organeve të policisë (IDRA dhe UN women, 2018).

Të dhënat nga studimet flasin qartë për marrëdhënien ndërmjet dhunës në komunitet dhe në mjedisin familjar dhe dhunës në marrëdhëniet intime. Edhe pse nuk ka ende studime në kontekstin shqiptar që të analizojnë dhunën në marrëdhëniet intime në adoleshentë, gjetjet nga studime për dhunën në familje në Shqipëri (Haarr, 2013) dhe komunitet (Qirjako e të tjerë, 2013) na japin të dhëna të mjaftueshme për përmasat dhe praninë e faktorëve nxitës për DhMI-në mes adoleshentëve. Sipas rezultateve të përfutuara nga Haarr (2013), u gjet se 28.6% e pjesëmarrësve mendonin se fëmija mund të qëllohet me shuplakë kur gabon, ndërsa 7.7% thanë se ata i qëllonin fëmijët e tyre me rrip beli apo sende të tjera të forta. Më tej, një studim rreth dhunës ndaj fëmijëve në Shqipëri, (UNICEF, 2006) tregon se një në dy fëmijë në shtëpi dhe çdo një në tre fëmijë në shkollë, pranuan se dhuna ndaj tyre ishte e justifikueshme.

## **Besimet dhe qëndrimet e adoleshentëve në lidhje me dhunën në marrëdhëniet intime**

Besimet dhe qëndrimet rreth rezultateve të dhunës ndikojnë shumë ushtrimin e DHMI-së. Pra nëse dikush mendon se dhuna ka efekte pozitive, kjo e lehtëson përdorimin e dhunës. Ekspozimi ndaj keqtrajtimit dhe dhunës në fëmijëri rrit në mënyrë të konsiderueshme rrezikun për t'u bërë dhunues dhe për të qenë viktimë në një sërë kontekstesh (Grych dhe Swan, 2012). Goncy e të tjerë (2017) konfirmuan gjetjet nga studime të mëparshme se, *adoleshentët që ishin agresivë në marrëdhëniet e tyre intime ishin agresivë edhe në ambjente të tjera*. Shfaqja e agresivitetit në kushtet kur kthehet në një model "normal" ndërveprimi, mund të kthehet në tipar të qëndrueshëm të sjelljes gjatë gjithë jetës. Adoleshentët viktimë të dhunës në një marrëdhënie ishin viktimë ose agresorë edhe në marrëdhënie të tjera (po aty fq.65). Po ashtu besimet dhe qëndrimet tolerante ndaj dhunës ndërveprojnë pozitivisht me përjetimin e dhunës në marrëdhëniet intime mes adoleshentëve (McDonnell dhe të tjerë, 2010).

Në Shqipëri, studime të tjera të lidhura me dhunën në marrëdhëniet intime dhe marrëdhëniet familjare tregojnë për një nivel të lartë të dhunës në marrëdhëniet intime. Kështu sipas studimit për dhunën në marrëdhëniet familjare të realizuar nga INSTAT dhe UNDP në vitin

2013, në të gjithë Shqipërinë, më shumë se gjysma e grave raportojnë të kenë përjetuar dhunë në familje, në martesë/marrëdhënie intime “gjatë jetës”, dhe gjysma e tyre kishin përjetuar dhunë në familje “aktualisht” (brenda 12 muajve para intervistës). Ky nivel i lartë dhune brenda familjes shqiptare padyshim që ndikon në sjelljet e dhunshme të fëmijëve dhe adoleshentëve. Më tej, ajo ndikon në krijimin e modelit të dhunshëm si një mënyrë “normale” ndërveprimi edhe mes njerëzve të dashur. Jo vetëm trashëgohet modeli i dhunës si model “funksional” ndërveprimi, por edhe modelet e të kërkuarit ndihmë trashëgohen gjithashtu. Studime të ndryshme tregojnë se vajzat më shpesh se djemtë janë viktima të dhunës në marrëdhëniet intime dhe djemtë janë agresorë më shpesh se vajzat (McDonnell e të tjerë 2010; dhe Wincentak e të tjerë, 2017). Siç theksohet më sipër, adoleshentët që vijnë nga kontekste familjare apo komunitare me nivel të lartë të dhunës në marrëdhëniet ndërpersonale janë më pak të prirur të kërkojnë ndihmë (Hébert e të tjerë, 2014).

Besimet dhe qëndrimet e adoleshentëve në lidhje me dhunën në marrëdhëniet intime ndikohen fuqimisht nga konteksti komunitar, familjar dhe miqësor i adoleshentëve. Por ajo që është më e rëndësishmja, është se edhe thyerja e ciklit të dhunës edhe reagimi ndaj dhunës, duket se ndikohen nga i njëjti kontekst. Sa më të ekspozuar të jenë adoleshentët ndaj sjelljeve të dhunshme në mjedisin e tyre, aq më shumë ata familjarizohen me dhunën duke e pranuar atë si një realitet dhe aq më pak janë të prirur të reagojnë kur janë vetë viktima apo vëzhgues të sjelljeve të dhunshme.

# Analizë e gjetjeve

## Karakteristikat e Pjesëmarrësve dhe Eksperienat në Marrëdhëniet Intime

### *Informacion demografik*

Të dhënat demografike u analizuan sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, klasës që ndiqnin në shkollë të mesme, frekuentimit në shkollë, të ardhurave të familjes të ndara sipas gjinisë së prindërve dhe nivelit arsimor të prindërve.


Në këtë studim morën pjesë 1036 të rinj nga të cilët 428 djem, 593 vajza dhe 15 që nuk e kishin specifikuar gjininë. Shpërndarja e moshave që paraqitet në grafikun nr 1. shpjegon se 27 përqind e të anketuarve ishin 16 vjeç, 38 përqind ishin 17 vjeç, 31 përqind ishin 18 vjeç. Vetëm 3 përqind e tyre ishin mbi 18 vjeç. 56 përqind e të rinjve ishin nga zonat urbane dhe 44 përqind nga zonat rurale. 2 përqind e të rinjve e të rejave ishin nga komuniteti Rom e Egjiptian<sup>3</sup>. Kjo e dhënë mund të jetë dhe një tregues i mosfrekuentimit të shkollës së mesme nga të rinjtë dhe të rejat e këtij komuniteti, duke iu referuar diskriminimit që ata ndjenë dhe çështjeve të tjera të mirënjohura të lidhur me këtë komunitet në vend.

Të rinjtë u pyetën në lidhje me të ardhurat familjare dhe punësimin e prindërve. Rreth një e treta e fëmijëve, 30 përqind, raportojnë se të ardhurat e familjes së tyre variojnë mes 30.000-70.000 leke në muaj, 19 përqind raportojnë se të ardhurat e familjes së tyre janë më pak se 30.000 lekë në muaj dhe 17 përqind raportojnë se të ardhurat e familjes së tyre janë më shumë se 70.000 lekë në muaj. Rreth një e treta e të rinjve shprehen se nuk kanë informacion në lidhje me të ardhurat mesatare të familjes së tyre (33 përqind).

---

<sup>3</sup> Sot në Shqipëri njihet minoriteti etno-linguistik Rom dhe komuniteti Egjiptian, por nuk ka të dhëna të sakta për madhësinë e këtij komuniteti. Nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në vitin 2011 u identifikuan vetëm 8.300 romë dhe 3.368 egjiptianë, rreth 3-4% të totalit të popullsisë. Të dhëna nga Plani kombëtar i veprimtimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020 bazuar në studime të ndryshme nga organizatat e komunitetit të njohura nga institucione ndërkombëtare në vend, raportojnë për 18.276 deri në 120.000 romë dhe për më shumë se 200.000 egjiptianë. Nëse i referohemi shifrave të fundit, ky komunitet përbën më shumë se 10% të totalit të popullsisë shqiptare dhe na bën të mendojmë se të rinjtë e këtij komuniteti nuk janë të përfaqësuar mjaftueshëm në studim.

**Figura 1. Shpërndarja demografike e kampionit**



Prindërit e të rinjve ishin kryesisht me arsim të mesëm, 49 përqind e baballarëve dhe 44 përqind e nënave. 18 përqind e baballarëve dhe 25 përqind e nënave ishin me arsim fillor dhe një numër i papërfillshëm pa arsim. Rreth një e pesta e të rinjve kishin prindër me arsim të lartë, 17 përqind e baballarëve dhe 18 përqind e nënave. Të dhënat në lidhje me arsimin dhe punësimin e prindërve flasin për një kampion përfaqësues të familjeve në Shqipëri referuar të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë dhe banesave të vitit 2011.

Lidhur me punësimin, 36 përqind e baballarëve ishin të punësuar në sektorin privat dhe publik, ndërsa 26 përqind ishin të vetpunësuar. Vetëm 8 përqind ishin të papunë ose joaktiv në tregun e punës. Ndërkohë, lidhur me nënat, 36 përqind e tyre ishin shtëpiake dhe 8 përqind të papuna, 32 përqind të punësuar në sektorin privat dhe publik dhe 14 përqind ishin të vetpunësuar.

Në këtë pjesë të studimit paraqiten gjetjet nga analiza e rezultateve të pyetësorit për dhunën në marrëdhëniet intime midis adoleshentëve të grup moshës 16-18 vjeç dhe gjetjet nga fokus grupet. Pyetësori u hartua me pyetje të mbyllura dhe pjesa më e madhe e pyetjeve të pyetësorit lejonte që pjesëmarrësit të zgjidhnin përgjigjet “nuk e di” ose “nuk preferoj të përgjigjem”. Këto përgjigje janë përfshirë në analizën e të dhënave, por nuk paraqiten në shumicën e tabelave dhe figurave në këtë raport.

Rezultatet e studimit janë të grupuara në tre pjesë:

- *Pjesa e parë* paraqet të dhënat në lidhje me një sërë variablash të lidhur me sigurinë në komunitet, marrëdhënien e të rinjve me familjen dhe miqtë, besimet dhe qendrimet e tyre ndaj dhunës me bazë gjinore.
- *Pjesa e dytë* trajton rezultatet në lidhje me këndvështrimet për dhunën dhe eksperiencën e tyre me dhunën në përgjithësi. Më tej në këtë pjesë trajtohet eksperiencia e të rinjve me marrëdhëniet intime dhe këndvështrimet mbi sjelljen në marrëdhëniet intime si dhe me dhunën në marrëdhëniet intime. Pjesa e dytë mbyllet me një analizë të si dhe çfarë mendojnë ata në lidhje me ndihmën që mund t'i kërkojnë anëtarëve të familjes apo miqve në situata të vështira.
- *Pjesa e tretë* analizon përgjigjet e të rinjve dhe të rejave në lidhje me konsumin e alkoolit, duhanit dhe lëndëve narkotike. Në këtë pjesë shihet korrelacioni i përdorimit të tyre me ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet intime.

*Të gjitha gjetjet e këtij studimi janë analizuar nën këndvështrimin gjinor.*

## PJESA E PARË

# Dhuna në marrëdhëniet intime në adoleshencë

Pjesa e parë trajton eksperiencat e të rinjve me marrëdhëniet intime dhe këndvështrimet mbi sjelljen në marrëdhëniet intime si dhe me dhunën në marrëdhëniet intime. Në këtë pjesë të rinjtë pyeten për konsumin e alkoolit, duhanit dhe lëndëve narkotike dhe shihet korrelacioni i përdorimit të tyre me ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet intime. Një seksion i rëndësishëm i kësaj pjese lidhet me atë çfarë mendojnë pjesëmarrësit në lidhje me ndihmën që mund t'i kërkojnë anëtarëve të familjes apo miqve kur janë viktimat të dhunës në marrëdhëniet intime.


### **Ekspozimi i të rinjve ndaj dhunës**

Ekspozimi i të rinjve ndaj dhunës në familje, qoftë kjo mes prindërve apo i prindërve ndaj fëmijëve, rrit ndjeshëm shfaqjen e sjelljeve agresive dhe viktimizimin e adoleshentëve në marrëdhëniet intime (Wincentak e të tjerë, 2017). Për të llogaritur nivelin e ekspozimit ndaj formave të ndryshme të dhunës, u kombinuan disa variabla të përdorur në pyetësor.

I/e ekspozuar ndaj dhunës, në këtë studim konsiderohet çdo i ri/e re që:

- Njeh një të ri/e të dhunuar nga partneri/partnerja
- Njeh një të ri/e të dhunuar në familje
- Njeh një të ri/e të dhunshëm

**Figura 2. Ekspozimi ndaj dhunës nëpërmjet miqve/të njohurve**



Nga kombinimi i variablave rezulton se *dy në tre adoleshentë, njohin miq që janë viktime të dhunës nga partneri/ia apo nga familja dhe/ose njohin një vajzë/djalë të dhunshëm.*

Si edhe duket në figurën 2, mundësitë që të rinjtë të njohin vajza viktime të dhunës nga partneri dhe ose familja janë më të mëdha se djem viktime të dhunës. 38 përqind e të rinjve pjesëmarrës njohin të paktën një vajzë të dhunuar nga familja dhe 29 përqind e të rinjve njohin një djalë të dhunuar nga familja. Diferencat gjinore janë tepër të mëdha në rastin e dhunës nga partneri. Të dhënat na tregojnë se *të rinjtë njohin 4 herë më shumë vajza të dhunuara nga partneri se djem të dhunuar nga partneri/ia.* Kjo e dhënë përputhet me pothuaj të gjitha gjetjet e mbledhura nga studime ndërkombëtare për dhunën në marrëdhënie intime (Jouriles e të tjerë, 2012; McDonell e të tjerë, 2010; Vézina dhe Hébert, 2007). Kjo është gjithashtu një gjetje që konfirmon praninë e dhunës ndaj vajzave dhe grave në shoqërinë tonë. Edhe pse siç e kemi theksuar më sipër nuk ka studime të dhunës në marrëdhëniet intime mes të rinjve, studimet për dhunën ndaj grave në Shqipëri tregojnë realitete të ndryshme për burrat dhe gratë, ku këto të fundit janë shpesh viktime.




Më tej 23 përqind e të rinjve pjesëmarrës shprehen se njohin një vajzë të dhunshme kundrejt 34 përqind të të rinjve që shprehen se njohin një djalë të dhunshëm. Gjithashtu, sipas disa studimeve afatgjata, DhMI lë një sërë pasojash negative (si p.sh. vetëbesim të ulët, sjellje anti-sociale, tentativë për vetëvrasje, sjellje ekstreme mbi kontrollin e peshës apo përdorimi i substancave) në shëndetin e vajzave adoleshente sidomos kur ato kalojnë në moshën e rritur (Ackard dhe Neumark-Sztainer, 2002; Exner-Cortens e të tjerë, 2013). Studime të tjera tregojnë se DhMI ka kosto të konsiderueshme sociale dhe ekonomike për gjithë shoqërinë (Hess dhe del Rosario, 2018). Shpeshherë viktimat e DhMI humbasin mundësitë për t'u arsimuar më mirë, për të punuar dhe/apo humbasin kontrollin mbi zgjedhjen dhe kohën e lindjes së fëmijës (Hess dhe del Rosario, 2018).

Nuk ka të dhëna për të analizuar nëse ekspozimi ndaj dhunës i të rinjve është rritur apo ulur megjithatë të dhënat flasin qartë për një situatë problematike dhe për praninë e dhunës si model ndërveprimi tepër të pranishëm në jetët e të rinjve, megjithë mospranimin e dhunës në nivel të lartë nga pjesëmarrësit e këtij studimi (rreth 75 përqind e trajtuar më lart).

Në lidhje me format e dhunës që të rinjtë kanë hasur më shpesh mes miqve të tyre, të ushtruar nga partneri/ja dhe ose familja, dhuna fizike dhe ajo psikologjike janë më shpesh të raportuara. Edhe studimet e bëra kryesisht në SHBA tregojnë se forma më e përhapur dhunës ndaj të cilës të rinjtë janë më të ekspozuar është dhuna fizike dhe më pas ajo psikologjike dhe seksuale (Finkelhor e të tjerë, 2009; Finkelhor e të tjerë, 2011; Herrera dhe Mcloskey, 2001).

**Figura 3. Format e dhunës ndaj të cilave janë ekspozuar të rinjtë dhe të rejat – nga Partneri ose familja**




Të pyetur mbi format e dhunës së ushtruar ndaj vajzave qoftë nga partneri intim, qoftë nga familja, të rinjtë raportuan se në rreth 70 përqind e rasteve të dhunës ndaj një shoqeje, kanë qenë të natyrës fizike, e ndjekur nga ajo psikologjike me rreth 60 përqind. Grafiku i mësipërm tregon që dëshmitarët direktë apo jodirektë të dhunës ndaj vajzave, pohojnë edhe njëherë që *vajzat dhunohen afërsisht në të njëjtën masë si nga partneri ashtu edhe nga familja*. Për më tepër edhe format e dhunës së ushtruar ndaj tyre nuk ndryshojnë thelbësisht. Kështu dëshmitarët e dhunës ndaj vajzave pohojnë se rreth 71-73 përqind e vajzave të dhunuara pësojnë dhunë fizike, si nga partneri ashtu edhe nga familja dhe rreth 60 përqind pësojnë dhunë psikologjike.

Shifrat e dhunës fizike nga partneri nuk ndryshojnë shumë nga dhuna fizike nga familja, por dhuna psikologjike dhe ajo seksuale ishin me differencë rreth 3 përqind nga dhuna ekonomike e dixhitale.


Dhuna në familje është një fenomen që i përfshin të gjitha llojet e dhunës si p.sh, dhuna me partner intim, dhuna me bazë gjinore, dhuna në çift, dhuna ndaj fëmijëve etj. Në të shumtën e rasteve vajzat/gratë janë ato që vuajnë më shumë pasojat sidomos të dhunës fizike dhe psikologjike (Foshee e të tjerë, 1999; Hornor, 2005; Molidor dhe Tolman, 1998). Edhe në këtë studim raportohet e njëjta situatë ku 391 pjesëmarrës (38 përqind) raportuan që njihnin një vajzë viktimë të dhunës nga familja dhe 358 pjesëmarrës raportuan që njihnin një vajzë viktimë të dhunës nga partneri.

## Eksperienat e të rinjve me marrëdhëniet intime

Figura 4. Mosha mesatare e krijimit të marrëdhënieve intime




**Figura 5. Numri i partnerëve intimë**



Të rinjtë u pyetën në lidhje me eksperiencat e tyre në marrëdhëniet intime. 49 përqind e tyre kane deklaruar që kanë qenë të paktën një herë në një marrëdhënie intime, dhe 19 përqind e tyre refuzojnë të përgjigjen. Moshë mesatare në të cilën ata kanë filluar të kenë marrëdhënie intime, është 16 vjeç. Djemtë fillojnë aktivitetin seksual një vit më herët se vajzat (15.8 vjeç përkundrejt 16.8 vjeç). Numri mesatar i partnerëve intimë përgjatë jetës së një të riu/reje 16-19 vjeç është 2 deri në 3 (2.4 mesatarja), ku djemtë raportojnë një numër më të madh partnerësh seksuale në raport me vajzat, respektivisht 1.6 dhe 0.8 partnerë seksualë gjatë 12 muajve të fundit.

Studimi nxjerr në pah një të dhënë tepër shqetësuese për shëndetin seksual dhe riprodhues tek të rinjtë, veçanërisht tek vajzat. Më shumë se gjysma e vajzave (54 përqind) dhe një e treta (31 përqind) e djemve, nuk kanë përdorur asnjë metodë kontraceptive ose kanë përdorur vetëm tërheqjen. Mos përdorimi i metodave të kontracepsionit i ekspozon djemtë dhe vajzat ndaj sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Studimet e bëra kryesisht në SHBA raportojnë fakte akoma më shqetësuese, ku vetëm në dy dekadat e fundit rreth 1 milion vajza adoleshente të moshës 15-19 vjeç kanë mbetur shtatzënë dhe rreth 90 përqind e tyre kanë mbetur në mënyrë të paqëllimshme. Sipas të njëjtit studim çdo vit shfaqen raste me sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe në një të katërtën e tyre raportohen të jenë kryesisht vajza të moshës 15-19 vjeç (Cubbin e të tjerë, 2005). Në studimin tonë, nga të rinjtë e përfshirë në marrëdhënie intime rreth 62 përqind përdornin kontraceptive ose prezervativë.

**Figura 6. Përdorimi i metodave kontraceutive**



**Tabela 3. Metodrat kontraceutive që përdorin të rinjtë**


	Vajza	Djem	Të gjithë
Asnjë/Tërheqje	54 %	31 %	37 %
Kontraceutivë/Prezervativë	44 %	68 %	62 %
Tjetër/Nuk e di	6 %	5 %	6 %

Vihet re se *djemtë janë më të vëmendshëm në përdorimin e metodave të mbrojtjes gjatë aktit seksual*. 57 përqind e djemve kanë përdorur prezervativ dhe vetëm 39 përqind e vajzave kanë përdorur metoda mbrojtjeje herën e fundit që kanë kryer marrëdhënie seksuale. Ka disa faktorë gjinorë të lidhur me këtë çështje, si për shembull djemtë e fillojnë jetën seksuale një vit më herët se vajzat dhe janë më të predispozuar të ndryshojnë më shpesh partnere. Megjithatë studimet tregojnë se ka shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në përfshirjen e të rinjve në marrëdhëniet intime, si statusi socio-ekonomik i familjes apo siguria në komunitet (Billy e të tjerë, 1994).

Në figurën 7 paraqiten të dhënat e të rinjve që kanë konsumuar lëndë narkotike, duhan dhe alkool të grupuara në të rinj që kanë kryer marrëdhënie seksuale dhe të rinj që nuk kanë kryer

marrëdhënie seksuale. Të dhënat tregojnë se të rinjtë që kanë kryer marrëdhënie seksuale janë më të predispozuar të tentojnë përdorimin e lëndëve narkotike, duhanit, alkoolit apo të përfshihen në sjellje kriminale dhe arrestohen nga policia.

**Figura 7. Konsumi i duhanit, alkoolit dhe lëndëve të tjera gjatë 12 muajve të fundit dhe lidhja e tyre me kryerjen e marrëdhënieve seksuale**




### Këndvështrimet e të rinjve mbi sjelljet në marrëdhëniet intime

Qëndrimet e adoleshentëve ndaj dhunës vazhdimisht tregojnë se ndikojnë në viktimizim apo në ushtrimin e DhMI. Sipas studimeve, nëse të rinjtë mendojnë se dhuna nuk ka justifikim, kjo e ul rrezikun e shfaqjes së DhMI (McDonell e të tjerë, 2010).

Të rinjtë e të rejat që morën pjesë në studim u pyetën se sa të pranueshme i konsiderojnë ata një sërë sjelljesh të dhunshme në marrëdhëniet intime. Pyetjet masnin kryesisht qëndrimin e të rinjve ndaj sjelljeve dhunuese psikologjike dhe verbale, të dhunës fizike dhe seksuale. Në një shkallë nga një në pesë, ata vlerësuan si të pranueshme dhe të papranueshme secilën prej sjelljeve të listuara në pyetësor.

Të dhënat u grupuan më pas në tre kategori: 1) e papranueshme, që përfshin plotësisht e papranueshme dhe e papranueshme; 2) disi e pranueshme dhe; 3) e pranueshme, që përfshin plotësisht e pranueshme dhe e pranueshme).


**Figura 8. Shkalla e pranimit të DhMI nga të rinjtë**



Si edhe vihet re në figurën më lart, rreth 95 përqind e të rinjve e konsiderojnë të papranueshme dhunën seksuale. Mbi 80 përqind e tyre konsiderojnë gjithashtu të papranueshme dhunën fizike; “ta shkundësh ose ta shtysh, ta gjuash me shuplaka ose ta godasësh”; dhe disa sjellje të lidhura me dhunën psikologjike dhe emocionale si: “të përndjekësh dhe ngacmosh vazhdimisht partnerin, t’i bërtasësh në vende publike”, “të dëmtosh objektet personale të partnerit/es”, si edhe “të tallësh me veshjen dhe mënyrën se si duket”. Ky rezultat përputhet me gjetje nga shumë studime të tjera, të cilat kanë dalë në përfundimin se qëndrime të ndryshme kanë tendencën t’i bëjnë të rinjtë më të prirur ndaj ushtrimit të dhunës ose jo (Reed e të tjerë, 2011; dhe Temple e të tjerë, 2013).

64 përqind e të rinjve e konsiderojnë si të pranueshëm kontrollin e aktivitetit të partnerit/es në rrjetet sociale, 52 përqind e konsiderojnë të pranueshme të përcaktosh me kë të shoqërohet partneri/ia ose jo, 38 përqind e konsiderojnë si të pranueshme t’i bërtasësh partnerit/es kur janë vetëm dhe 28 përqind e konsiderojnë partnerin/partneren dhe të refuzosh të flasësh me të.

**Figura 9. Shkalla e pranimit të DhMI mes adoleshentëve që kanë kryer marrëdhënie seksuale, kundrejt atyre që nuk kanë kryer më parë marrëdhënie seksuale**



*Shkalla e pranimit të thujtse të gjitha formave të presionit në çift, rritet kur të rinjtë kanë qenë ose janë në një marrëdhënie intime siç shihet qartë në figurën më lart.*


Midis të rinjve që nuk kanë kryer ndonjëherë marrëdhënie seksuale, këto sjellje dhunuese duken të papranueshme. Ndërsa për ata të rinj që kanë qenë në një marrëdhënie intime, këto sjellje dhunuese fillojnë të duken më të pranueshme.

Veçanërisht sjelljet “kontrolluese” si “t’i kontrollosh rrjetet sociale”, “me kë mund të shoqërohesh”, “t’i imponohesh”, konsiderohen si të pranueshme në një shkallë më të lartë nga ata që kanë qenë ndonjëherë në një marrëdhënie intime, sesa ata që nuk kanë qenë. Respektivisht 55 përqind kundrejt 38 përqind, 53 përqind kundrejt 36 përqind dhe 40 përqind kundrejt 16 përqind i kanë raportuar sjelljet e mësipërme si të pranueshme.

## Shfaqja e dhunës në marrëdhëniet intime tek të rinjtë 16-19 vjeç

Të dhënat e studimit tregojnë se 22 përqind e të rinjve që në një moment të jetës së tyre kanë qenë në një marrëdhënie intime me dikë, kanë deklaruar të kenë qenë viktimë të së paktës një forme dhune nga partneri/ja (psikologjike, fizike, seksuale etj). Duhet theksuar se 20 përqind e të rinjve refuzojnë të përgjigjen nëse kanë qenë ndonjëherë në një marrëdhënie intime gjë që e vështirëson përlllogaritjen e plotë të dhunës në marrëdhëniet intime. McDonnell e të tjerë (2010) bazuar në studime të tjera konkludojnë se një në tre adoleshentë ka përjetuar një formë të dhunës në marrëdhëniet intime gjatë adoleshencës.

Figura 10. Shfaqja e dhunës në marrëdhëniet intime (DhMI) mes adoleshentëve




Të dhënat gjithashtu tregojnë se vajzat dhunohen më shumë nga partnerët e tyre sesa djemtë. Respektivisht, 28 përqind e vajzave dhe 20 përqind e djemve kanë deklaruar të kenë qenë viktimë të dhunës nga partneri/ja.

Rezultate të ngjashme janë vënë re edhe nga studime të tjera në kontekste të tjera. Kështu, Exner-Cortens e të tjerë (2013) vunë re se edhe pse viktimizimi apo ushtrimi i dhunës ndaj një partneri intim ekziston si tek djemtë ashtu edhe tek vajzat, vajzat janë ato që bien më shumë pre e dhunës fizike dhe seksuale nga djemtë.



**Figura 11. Lloji i dhunës së pësuar nga partneri/a. Vetëm ata që janë apo kanë qenë në një moment të jetës së tyre në një marrëdhënie intime**



Gjithashtu edhe *lloji i dhunës së ushtruar ndryshon në varësi të gjinisë*. Vajzat kërcënohen, poshtërohen (20 përqind kundrejt 8 përqind) apo dhunohen fizikisht (18 përqind kundrejt 6 përqind) nga partnerët e tyre thuhetse 3 herë më shumë se sa djemtë nga partneret e tyre. Kurse dhuna seksuale e ushtruar nga partnerët, e parë kjo, qoftë nëpërmjet detyrimit për prekje në pjesët intime, apo shtrëngimit për marrëdhënie seksuale, raportohet gati njësoj si nga vajzat ashtu edhe nga djemtë (13 përqind kundrejt 10 përqind, ndryshim statistikiqisht jo domethënës).

Diferenca më të vogla u vunë re në dimensionet e dhunës seksuale. 13 përqind e vajzave deklarojnë të kenë qenë të detyruara të prekin partnerin në vende intime dhe janë detyruar të kryejnë marrëdhënie seksuale pa dëshirën e tyre (14 përqind e vajzave dhe 10 përqind e djemve për të dyja pyetjet).


Grupi i të rinjve që raportuan se kishin qenë të paktën një herë në marrëdhënie intime u analizua më tej për të parë nëse kishte lidhje ndërmjet dhunës në marrëdhëniet intime dhe variablave të tjerë të studimit.

*Të rinjtë që kanë qenë viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare janë tre herë më shumë të predispozuar të jenë dhe viktimë e dhunës në marrëdhëniet intime. Dhuna në familje përcakton edhe nëse marrëdhëniet intime do të preken nga dhuna. Ashtu siç raportohet nga shumë studime të tjera (Brendgen e të tjerë, 2002; Lichter & Mçloskey, 2004) të dhënat në këtë studim tregojnë se 43 përqind e të rinjve që kanë qenë viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare janë edhe viktimë e dhunës në marrëdhëniet intime. Të rinjtë që nuk kanë qenë viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare janë tre herë më pak të dhunuar.*

Rol të rëndësishëm në kampionin tonë luan edhe ekspozimi ndaj formave të dhunës. Të rinjtë që kanë në rrethin e tyre të dhunuar ose dhunues janë pothuaj dy herë më të predispozuar (24 përqind) të jenë viktimë të dhunës se ata që nuk kanë në rrethin e tyre viktimë ose dhunues (13 përqind).

Me interes duken dhe gjetjet në lidhje me pranueshmërinë e dhunës në marrëdhëniet intime. Toleranca ndaj sjelljeve të dhunshme rrit mundësinë e përjetimit të dhunës në marrëdhëniet intime. Mes të rinjve që e konsiderojnë deri diku të pranueshme dhunën përqindja e viktimave është më e lartë, 36 përqind krahasuar me të rinjtë që nuk e pranojnë dhunën, 18 përqind. Një lidhje vihet re edhe mes konsumimit të lëndëve narkotike, ku ata që kanë konsumuar lëndë narkotike janë më të predispozuar të jenë edhe viktimë të dhunës 27 përqind më shumë krahasuar me ata që nuk kanë konsumuar lëndë narkotike.

**Figura 12. Shkalla e dhunës së provuar nga partneri/ja në marrëdhëniet intime, sipas faktorëve të rrezikut**




Pavarësisht se ishte e pritshme lidhja mes sjelljeve, që ne i kemi identifikuar si sjellje të rrezikshme, dhe dhunës në marrëdhëniet intime, lidhja e fortë midis tyre është befasuese.

Shumica prej tyre e dyfishojnë probabilitetin e hyrjes në ciklin e dhunës: ekspozimi ndaj dhunës, niveli i pranueshmërisë së dhunës dhe përdorimi i lëndëve narkotike. **Ndërkohë të dhënat tregojnë se dhuna në familje pothuaj e trefishon mundësinë e të rinjve për të hyrë në ciklin e dhunës në marrëdhëniet intime.** Studimet (Naved dhe Persson, 2005; Xu, Zhu, O'Campo, Koenig, Mock dhe Campbell, 2005) tregojnë që ky fenomen është më i përhapur në zonat urbane sesa ato rurale. Por ky krahasim bëhet duke pasur parasysh një sërë faktorësh, sepse zakonisht DhMI ndodh më shumë në ato zona urbane ku ka një nivel të lartë varfërie, ku kryhen krime apo ku ka të rinj që vijnë nga familje të komuniteteve të ndryshme.

Në të tre pyetjet e lidhura me ekspozimin ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, të rinjtë viktimë të dhunës janë disa herë më shumë se të rinjtë jo viktimë të dhunës në marrëdhënie intime. 32 përqind e të rinjve viktimë të dhunës në marrëdhëniet intime kanë pasur frikë nga familjarët se mund t'iu rrezikojnë jetën, kundrejt 13 përqind të të rinjve jo viktimë të DhMI. 21 përqind e tyre kanë parë familjarë që dhunohen kundrejt 3 përqind që nuk janë viktimë e dhunës në marrëdhëniet intime. 10 përqind e viktimave janë në dijeni për pjesëtarë të familjes së tyre të abuzuar seksualisht krahasuar me 2 përqind të të rinjve që nuk janë viktimë të dhunës në marrëdhëniet intime.

**Figura 13. Marrëdhënia ndërmjet dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës në marrëdhëniet intime**




Lidhja e qartë mes dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës në marrëdhëniet intime mes të rinjve është një tregues tepër shqetësues për mirëqenien e të rinjve dhe ndikimin që ka familja në modelimin e sjelljeve agresive dhe mbrojtëse tek ta. Cikli i dhunës mesa

duket nuk mbetet brenda familjes, por kthehet në faktorin kryesor të krijimit të efektit domino në përhapjen e dhunës si model të pranueshëm ndërveprimi edhe mes të rinjve dhe më pas në të gjitha nivelet e shoqërisë.

## Marrja ndihmë nga të tjerët në rast të dhunës në marrëdhënie intime


Rreth gjysma e të rinjve raportojnë se ka pak ose aspak mundësi t'i tregojnë dikujt në rast se janë viktimë e një dhunimi psikologjik, fizik apo seksual. Siç edhe vihet re në grafikun e mëposhtëm, prindërit miqtë dhe psikologu/psikologjia janë personat ku të rinjtë do të kërkojnë mbështetje. Nuk ka ndryshime të mëdha mes preferencës së prindërve apo bashkëmoshatarëve. Në rastin e dhunës seksuale 44 përqind e të rinjve do i drejtoheshin prindërve krahasuar me 41 përqind bashkëmoshatarëve dhe 40 përqind psikologut/es.

Figura 14. Modelet e të kërkuarit ndihmë në rast dhune nga partneri




Të dhënat u krahasuan edhe mes vajzave dhe djemve. Siç vihet re djemtë janë më të predispozuar se vajzat të mos kërkojnë ndihmë në rastin kur janë viktimat të dhunës. Kampioni nuk na ofron mundësinë të analizojmë vetëm djemtë e dhunuar, pasi përqindja e tyre ishte tepër e ulët. Djemtë do i drejtoheshin së pari miqve të tyre. Diferenca është e qëndrueshme për të treja llojet e dhunës.

**Figura 15. Modeli i të kërkuarit ndihmë në rast dhune nga partneri sipas gjinisë**



Të dhënat paraqiten shqetësuese, në rastin kur të dhënat u krahasuan mes të rinjve që kishin kryer marrëdhënie seksuale dhe atyre që nuk kishin kryer marrëdhënie seksuale. Të dhënat tregojnë se në rastin kur të rinjtë realisht përjetojnë apo kanë përjetuar një lidhje bëhen më tolerantë ndaj formave të dhunës dhe më pranues të sjelljeve të dhunshme. Në mënyrë të veçantë vihet re një ulje e përqindjes së të rinjve që do të flisnin me prindërit dhe një ulje më e lehtë e të rinjve që do të flisnin me miqtë dhe me psikologun/en. Diferenca mes miqve dhe grupeve të tjera bëhet më e qartë.

**Figura 16. Modeli i të kërkuarit ndihmë në rast dhune nga partneri sipas aktiviteti seksual**



Kjo e dhënë përkon më së miri edhe me studime të tjera të kryera në fushën e dhunës në marrëdhëniet intime (Garthe e të tjerë, 2017; Hebert e të tjerë, 2014; McDonell e të tjerë, 2010). Të rinjtë janë më të predispozuar të kërkojnë ndihmë tek miqtë e tyre kur janë viktimat të dhunës në marrëdhëniet intime.

### Të dhëna nga fokus grupet

Të rinjtë pjesëmarrës në fokus grupe treguan se kishin miq që kishin kryer marrëdhënie seksuale që prej moshës së hershme 13 vjeçare. Ata treguan se të jesh në një marrëdhënie intime është deri diku e pranueshme mes të rinjve dhe në ndonjë rast edhe prindërit ishin në dijeni të marrëdhënieve të tyre, kryesisht vajzat.

Të pyetur në lidhje me metodat e mbrojtjes ndaj shtatzanisë u vu re se një pjesë e tyre nuk i njihnin mirë metodat. Ndërkohë disa prej tyre përmendën pilulat e kontracesionit.

*“Një shoqes sime i dashuri i blen një kokërr që ajo e pi një orë para se të kryejnë marrëdhënie seksuale.” (vajzë, 17 vjeç, Vlorë, qytet).*

*“Një shoqja ime, abortoi fëmijën në një klinikë private, nga ai moment ajo nuk është më e gëzuar dhe e qeshur, nuk flet më si më parë (vajzë 18 vjeç, Tiranë)*

Të rinjtë raportuan disa raste të miqve të tyre që përjetonin dhunë nga partnerët intimë. Rastet e përmendura përfshinin vajza të lidhura me djem moshatarë, ose më të mëdhenj në moshë, vajza të fejuara etj.

*“Kam një shoqe në moshën time, e fejuar me një djalë 10 vite më të madh. Që kur është fejuar, i fejuari e kufizon për mënyrën e të veshurit, aktivitetet ku do të marrë pjesë, nuk e lë të vijë në ekskursionet” (Vajzë, 17 vjeç, Vlorë, qytet)*

*“Kam një shoqe, është përballur shumë me dhunë psikologjike nga i dashuri i saj. Ajo i vuan shumë ofendimet, fyerjet dhe kërcënimet nga i dashuri i saj. Mendoj që është çështje mentaliteti” (Vajzë, 16 vjeç, Lezhë, qytet)*

*“Një shoqja ime mbeti shtatzënë, ishte 15 vjeç dhe prindërit e çuan që të abortonte” (vajzë, 15 vjeç, Vlorë, qytet)*

Për vajzat pjesëmarrëse në diskutim, dhuna në marrëdhëniet intime duhej menaxhuar fillimisht prej saj dhe nëse nuk do të arrinin ta zgjidhnin problemin do të kërkonin ndihmën e nënës dhe ose motrës më të madhe, për vajzat që kishin motra më të mëdha.

*Nëse ke pranuar një marrëdhënie të dhunshme duhet ta përballosh, kjo ka qenë zgjidhja që ke bërë... (vajzë 17 vjeç, Vlorë, qytet)*

*Nëse partneri im do më dhunonte... varet sa.. nëse do të ishte vetëm një herë do e falja, nëse vazhdon do përpiqesha ta zgjidhja vetë nëse nuk do të arrija do të flisja me mamin dhe motrën. (vajzë, 17 vjeç, Vlorë, qytet)*

Disa pjesëmarrës ishin më tolerues ndaj formave të kontrollit në çift si kontrolli i rrjeteve sociale, apo edhe me kë rri i dashuri/e dashura.

*“Do isha shumë kurioze të shihja veprimtarinë e tij në rrjetet sociale, do e kontrolloja por do përpiqesha ta mbaja sekret” (vajzë 17 vjeç, Vlorë, qytet)*

*“Nuk është normale që partnerët të kontrollojnë njëri - tjetrin. Një lidhje funksionon mirë nëse ka besim.” (vajzë, 17 vjeç, Lezhë qytet)*

## PJESA E DYTË


# Sjellje të rrezikshme

Pjesa e dytë e këtij studimi, analizon përgjigjet e të rinjve dhe të rejave në lidhje me konsumin e alkoolit, duhanit dhe lëndëve narkotike. Në këtë pjesë raportohet korrelacioni i përdorimit të tyre me ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet intime.

### Eksperiencat e të rinjve me duhanin, alkoolin dhe drogën.

Një pjesë me rëndësi në këtë studim ishte edhe matja e abuzimit me substancat mes të rinjve. Jo vetëm nga rezultatet e studimit, por edhe nga të dhënat nga fokus grupet u vu re një tolerancë e theksuar e përdorimit të alkoolit edhe në ambjentet familjare në një moshë fare të re. Në fokus grupin e realizuar në Vlorë me një grup vajzash në lidhje me dhunën në marrëdhëniet intime, ato u shprehën së që rreth moshës 12 vjeç kishin pasur të drejtë të pinin alkool në festat familjare.

Figura 17. Konsumi i duhanit, kanabisit dhe pijeve alkoolike




Gati një në dy të rinj të intervistuar, frekuentues të shkollës së mesme, ka provuar alkoolin ose duhanin në jetën e tij/saj, dhe një në 10 të rinj/reja kanë provuar marijuanën/apo kanabisin.

Të pyetur nëse kishin konsumuar alkool duhan dhe droga të tjera gjatë 12 muajve të fundit vihet re se më shumë se gjysma kanë konsumuar alkool, 1 ose 2 gota verë birrë ose alkool tjetër dhe 22 përqind shprehen se edhe janë dehur. 36 përqind e të rinjve janë shprehur se



në 12 muajt e fundit kanë tymosur cigare, 12 përqind kanë tymosur kanabis dhe 5 përqind kanë provuar lëndë narkotike tjetër. Por pavarësisht përqindjes që zënë qoftë konsumi i alkoolit, i duhanit apo kanabisit, ajo ç'ka i bashkon është mosha e hershme kur këto të fundit janë provuar për herë të parë. Midis zakoneve të sapo përmendura, alkooli fillohet i pari, rreth moshës 13 vjeç, ndjekur nga duhani në moshën 13 vjeç e gjysëm, dhe në fund kanabisi kur sapo mbushin 14 vjeç.

**Figura 18. Konsumimi i lëndëve duhanit alkoolit dhe lëndëve narkotike dhe të arrestuar nga policia, sipas gjinisë, gjatë 12 muajve të fundit**




Të krahasuara sipas gjinisë të dhënat tregojnë se djemtë më shumë se vajzat kanë konsumuar cigare, alkool dhe drogëra të tjera. Diferencat janë të konsiderueshme në të gjitha kategoritë.

### Lidhja ndërmjet sjelljeve të dhunshme dhe konsumimit të alkoolit, duhanit dhe drogave.

Të rinjtë pyeten nëse kanë përdorur substanca narkotike dhe alkool gjatë 12 muajve të fundit, pra që jo domosdoshmërisht janë përdorues të rregullt të tyre. Në një kryqëzim të të dhënave me tiparet e dhunuesve dhe viktimave rezulton se konsumimi i substancave gjatë 12 muajve të fundit ka ndikim të konsiderueshëm në sjelljet e dhunshme. Ata që kanë konsumuar substanca rezultojnë më shpesh edhe dhunues edhe viktimë të dhunës në marrëdhëniet intime.

Kjo gjetje është në një linjë me gjetje nga shumë studime të tjera të cilat tregojnë se të rinjtë që përdorin apo abuzojnë me substancat janë më të prirur për t'u përfshirë në sjellje të rrezikshme, siç është dhuna ndaj partnerit intim (Temple dhe Freeman, 2011, Roberts e të tjerë, 2003; Tapert e të tjerë, 2001).

**Figura 19. Marrëdhënia ndërmjet konsumit të substancave narkotike dhe sjelljeve të dhunshme**



Kjo diferencë e qëndrueshme mes atyre që kanë konsumuar dhe që nuk kanë konsumuar lëndë narkotike 12 muajt e fundit na bën të mendojmë se ka një lidhje mes përdorimit të substancave dhe sjelljeve të dhunshme. Për më tepër që kjo e dhënë përputhet edhe me studime kombëtare (INSTAT 2013, ISHP 2014) edhe me studime ndërkombëtare (McDonnell 2010). Megjithatë studime të mëtejshme janë të nevojshme për të eksploruar më tej këtë marrëdhënie.

### Të dhëna nga fokus grupe

Gjatë bisedave me të rinjtë vihej re një tolerancë për konsumimin e pijeve alkoolike që në moshë të re. Kështu vajzat pjesëmarrëse në fokus grupe deklarorin se ishte e pranueshme për familjarët që ato të pinin verë ose birra gjatë festave familjare që rreth moshës 15-16 vjeç.

*“Prindërit e mi kanë kantinë vere dhe më kanë kërkuar që të provoj verën dhe të mësohem me të. Që nga 11 vjeç unë e kam provuar verën. Rreth moshës 15 vjeç unë kam pirë verë ose birra në rastin e festave familjare”. (vajzë, 17 vjeç, Vlorë qytet)*

*“Në rastin e ndeshjeve të futbollit ndodh që të pi alkool me prindërit... unë pi birra...” (vajzë, 16 vjeç, Vlorë qytet)*

*“Eksperinca ime me duhanin ka filluar kur isha 13 vjeç, me cigaren e parë dhe tani që jam 17 vjeç pi gati dy paketa në ditë.” (djalë, 17 vjeç, Tirana).*

Të rinjtë pjesëmarrës treguan raste të ndryshme të bashkëmoshatarëve që kanë konsumuar kanabis, alkool dhe duhan. Megjithatë ata shprehen se këto sjellje janë më të përhapura mes djemve se mes vajzave, edhe pse nuk ka një ndarje të qartë mes gjinive.

*“Në rastin e festave me klasën më shumë se gjysma e pjesëmarrësve në festë janë dehur... ne bëjmë festa pothuajse çdo muaj.” (Vajzë, 16 vjeç, Vlorë, qytet)*

*“Një herë në plazh një nga vajzat e klasës kishte sjellë kanabis dhe e piu me djemtë e klasës... (Vajzë, 17 vjeç, Vlorë, qytet).*

*“Në një mbrëmje me klasën, kur isha 15 vjeç, kam provuar për herë të parë hashash.” (Djalë, 18 vjeç, Peshkopi, qytet)*

*“Të gjithë shokët e klasës time konsumojnë alkool në Party që organizohen. Disa shokë janë dehur keq e mezi i kemi dërguar në shtëpi.” (Djemtë në fokus grupin e Tiranës)*

*“Kemi dëgjuar që vajzat kur dehen e pësojnë keq, kemi dëgjuar edhe që përdhunohen” (djalë 18 vjeç, Tiranë).*

## PJESA E TRETË


# Siguria, marrëdhëniet me familjen dhe besimet në lidhje me dhunën

Kjo pjesë paraqet të dhënat lidhur me sigurinë në komunitet, marrëdhënien e të rinjve me familjen dhe miqtë, besimet dhe qëndrimet e tyre ndaj dhunës me bazë gjinore.

### Siguria në komunitet


Të rinjtë u pyetën në lidhje me sigurinë që ata ndjenin në mjedisin ku jetonin, në lagje, komunitet, shkollë etj., dhe 92 përqind e të rinjve shprehen se ndihen të sigurt në shtëpi dhe komunitetin ku jetojnë. Rreth 90 përqind shprehen se lagjja ku jetojnë është e sigurt, ndihen të sigurt në shtëpi gjatë natës, ndihen të sigurt kur kalojnë kohë në lagje gjatë ditës, dhe ndihen të sigurt në shkollë. 75 përqind e të rinjve besojnë që aktivitetet kriminale që ndodhin në lagjen e tyre kryhen nga të tjerë jashtë lagjes së tyre, por 25 përqind të tjerë mendojnë se kryhen nga persona që jetojnë rreth tyre. Ata u pyetën nëse do t'i përgjigjeshin dikujt që kërkonte informacion për diçka gjatë natës dhe përgjigjet e tyre ndahen pothuajse përgjysëm midis atyre që do të përgjigjeshin po ose jo.

Figura 20. Perceptimi mbi sigurinë në shtëpi, komunitet dhe shkollë



Siguria në komunitet u pa edhe nga këndvështrimi gjinor. Të grupuara sipas gjinisë të dhënat tregojnë modele të ngjashme mes vajzave dhe djemve në të gjithë dimensionet e seksionit për sigurisë. Diferenca të mëdha mes vajzave dhe djemve vihen re në pyetjen “A do i kthenit përgjigje dikujt në lagjen tuaj që ju ndalon gjatë natës dhe kërkon diçka”, pasi dy herë më shumë djem (68 përqind) se vajza (36 përqind) do të ndalonin t’i kthenin përgjigje.


**Sigura 21. Perceptimi mbi sigurinë në shtëpi, komunitet dhe shkollë sipas gjinisë**



## Marrëdhënia me familjen dhe miqtë


Marrëdhënia me familjen është një faktor i rëndësishëm që ndikon në dinamikën e zhvillimit të njeriut gjatë gjithë cikleve të jetës. Në mënyrë të veçantë gjatë adoleshencës kjo marrëdhënie bëhet tepër e rëndësishme. Megjithatë prindërit dhe fëmijët janë në një periudhë riformimi të marrëdhënies së tyre, tranzicioni nga i mitur në i rritur shpesh herë është i vështirë për t’u kuptuar nga të dy palët dhe për t’u përballuar. Ndërkohë që adoleshentët kërkojnë më shumë pavarësi, prindërit nuk heqin dot dorë nga kontrolli mbi ta. Kjo duket se është burimi kryesor i konfliktit mes tyre.

**Figura 22. Kontrolli prindëror sipas gjinisë**



Mbi 80 përqind e të rinjve të intervistuar shprehën se prindërit e tyre duan të dinë kur adoleshentët dalin me miqtë dhe cilët janë miqtë, duan të dinë ku janë fëmijët e tyre dhe më kë po shoqërohen. Shumë prindër kërkojnë të informohen nëse të rinjtë dalin nga rutina e përditshme. Për shkak të roleve të ndryshme gjinore kontrolli i prindërve mbi vajzat është më i madh. Kështu niveli i kontrollit tek vajzat shkon nga 89 - 97 përqind ndërkohë tek djemtë kontrolli prindëror varion nga 75 - 85 përqind. Këto të dhëna janë të ngjashme me gjetjet nga disa studime që konkludojnë se niveli i monitorimit të prindërve apo këmbëngulja e prindërve për të kontrolluar të rinjtë e të rejat adoleshentë është i lartë (Allison dhe Schultz, 2004; Holmbeck, 2018). Këta studiues theksojnë se ky është një ndër faktorët kryesorë që bëhet shkak për lindjen e konflikteve midis dy palëve.

**Figura 23. Marrëdhënia me prindërit**



Studiues të ndryshëm në fushën e psikologjisë i kushtojnë rëndësi të veçantë marrëdhënies mes prindërve dhe adoleshentëve. Komunikimi i vazhdueshëm mes prindit dhe fëmijës ku të dy palët diskutojnë me njëri-tjetrin dhe të dy palët e dëgjojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin bëhet tepër i rëndësishëm gjatë adoleshencës. (Baumrind, 1991)


Të dhënat e studimit tregojnë se rreth 40 – 45 përqind e të rinjve flasin rrallë ose shumë rrallë me prindërit. Madje 12 përqind e tyre shprehen se kanë konflikte të shpeshta me prindërit e tyre. Megjithatë thuhet gjysma e adoleshentëve flasin relativisht shpesh me prindërit e tyre për planet e së ardhmes, për marrëdhënien me mësuesit apo rreth shokëve e shoqeve. Por nga ana tjetër 58 përqind e të rinjve nuk flasin asnjëherë me prindërit e tyre për marrëdhëniet intime.

Vajzat pjesëmarrëse në fokus grupe u shprehën se kishin marrëdhënie të mira me prindërit dhe konsultoheshin shpesh me ta.

*“Për çdo gjë që më ndodh unë do flisja me prindërit qoftë e mirë apo e keqe.” (Vajzë 14 vjeç, Lezhë, qytet)*


*“Unë do flisja më shumë me mamën dhe motrën. Edhe nëse do kisha problem me të dashurin mbase më shumë motrës, por pse jo edhe mamit.” (Vajzë, 16 vjeç, Vlorë)*

**Figura 24. Marrëdhënia me prindërit sipas rajoneve**



Në figurën më sipër paraqiten rezultatet e kombinimit të variablave për të parë se si ishte marrëdhënia me prindërit sipas rajoneve duke patur parasysh Tiranën, qytetet e tjera dhe zonat rurale. Të rinjtë e të rejtat e Tiranës, duket se komunikojnë më rrallë me prindërit e tyre, sesa shokët e tyre në qytetet e tjera apo fshatra, për çështje si e ardhmja, miqtë dhe mësuesit. Ndërsa marrëdhëniet intime, mbeten njësoj tabu për të gjithë të rinjtë kudo që ndodhen. Vetëm rreth 13 përqind e tyre diskutojnë për marrëdhëniet intime me prindërit. Me ndryshime të pakta nga ata në zonën rurale rreshtohen të rinjtë e të rejtat e qyteteve të ndryshme, por të rinjtë e të rejtat nga Tirana kanë diferenca të ndjeshme me shokët e shoqet e tyre kur diskutojnë çështjet e lartpërmendura, me rreth 12 -13 përqind më pak edhe se mesatarja e përgjithshme pothuaj në të gjitha pyetjet.

**Figura 25. Frekuenca e komunikimit me prindërit**



Rezultatet për të njëjtat pyetje u krahasuan edhe mes vajzave dhe djemve. Të dhënat tregojnë se ekzistojnë diferenca të mëdha gjinore në natyrën e komunikimit të të rinjve me prindërit. Kështu vajzat komunikojnë thuhetse po aq shpesh sa djemtë me prindërit e tyre për planet e së ardhmes, ndërsa për çështje si mësuesit dhe miqtë, përqindja e vajzave që flasin relativisht shpesh me prindërit është thuhetse dyfish më e lartë se ajo e djemve. Nga ana tjetër, marrëdhëniet konfliktuale me prindërit shfaqen njësoj si tek vajzat edhe tek djemtë, me 13 dhe 10 përqind përkatësisht për vajzat dhe djemtë. Dhe po aq tabu shfaqet edhe marrëdhënia intime, ndonëse vajzat që flasin për të me prindërit janë në një përqindje më të lartë se djemtë.




## Besimet e të rinjve në lidhje me dhunën

Të rinjtë pjesëmarrës në studim u pyetën në lidhje me disa këndvështrime të lidhura me dhunën në marrëdhëniet intime. Fillimisht ata u pyetën në lidhje me besimet e tyre mbi çfarë e shkakton dhunën. Këndvështrimet e adoleshentëve mbi dhunën janë një tregues i rëndësishëm për prezencën e dhunës në marrëdhëniet intime mes të rinjve (Reed e të tjerë, 2011; Temple e të tjerë, 2013). Mënyra sesi ata mendojnë rreth këtij fenomeni ul ose rrit rrezikun e shfaqjes së DhMI (McDonell e të tjerë, 2010).

Bazuar në këto gjetje nga studiues ndërkombëtarë, pjesëmarrësit u pyetën nëse ishin dakord ose jo me disa nga shkaktarët e dhunës. 75 përqind e të rinjve ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin se përdorimi i alkoolit dhe drogës shkaktojnë dhunë, kundrejt 24 përqind të të rinjve që ishin kundër dhe plotësisht kundër këtij pohimi. Kjo gjetje mbështetet nga shumë studime të tjera të cilat theksojnë se sidomos përdorimi i alkoolit është një nga faktorët me ndikimin më të lartë në shfaqjen e sjelljeve të rrezikshme si ajo e dhunës në marrëdhëniet intime (Rothman e të tjerë, 2012).

**Figura 26. Besimet e të rinjve në lidhje me shkaqet e dhunës**




Ashtu si edhe në shumë teori feministe theksohet se sjelljet dhe qëndrimet seksiste dhe pabarazia midis grave e burrave në një shoqëri patriarkale, janë ndër shkaqet kryesore të DhMI (Bell dhe Naugle, 2008), edhe në këtë studim, të dhënat na tregojnë se 73 përqind e pjesëmarrësve ishin plotësisht dakord me pohimin se dhuna shkaktohet nga sjelljet dhe

qëndrimet diskriminuese ( $M=2.8$ ), 69 përqind ishin të mendimit se dhuna shkaktohet nga qëndrimet seksiste ( $M=2.8$ ) dhe rreth 65 përqind besonin se personat që sillen dhunshëm kanë probleme psikologjike ( $M=2.7$ ). Një përqindje më e vogël e të rinjve besonin se ekspozimi ndaj filmave, videove muzikore dhe programeve televizive me përmbajtje të dhunshme rrit mundësinë për të kryer sjellje të dhunshme, 40 përqind e tyre ( $M=2.7$ ).

Studimi tregoi që pjesa dërrmuese e të rinjve kanë qëndrime negative ndaj dhunës. Megjithatë 77 përqind e të tyre ishin dakord me pohimin që dhuna është e lejueshme në rastet kur përdoret për vetëmbrojtje ( $M=3.0$ ), ndërkohë 61 përqind e tyre janë dakord dhe plotësisht dakord me pohimin se nuk ka asnjë justifikim përdorimi i dhunës ndaj një personi tjetër ( $M=2.8$ ). 75 përqind e të rinjve shprehen se janë kundër dhe plotësisht kundër përdorimit të dhunës për t'u hakmarrë ndaj personave që tregojnë mungesë respekti ( $M=2.8$ ). 88 përqind e të rinjve shprehen kundër pohimit se dhuna është i vetmi mjet për të marrë çfarëdo në jetë ( $M=1.5$ ).

**Figura 27. Qëndrimet e të rinjve ndaj sjelljeve të dhunshme**




Pjesa dërrmuese e të rinjve shqiptarë mendojnë se dhuna mund të përdoret për vetëmbrojtje në rast të sulmeve ndaj personit. Por më shumë se gjysma e tyre shprehen se dhuna nuk duhet të ushtrohet në asnjë rast tjetër kurrsesi. Gëithashtu rreth 90% e të rinjve nuk janë dakort që nëpërmjet përdorimit të dhunës njerëzit mund të arrijnë gjithçka në jetë.

## Qëndrimi i të rinjve ndaj dhunës ndaj vajzave dhe grave

Nisur nga niveli i lartë i dhunës ndaj vajzave dhe grave në vend mbështetur nga studime kombëtare (UNDP dhe INSTAT, 2013) të rinjtë u pyetën në lidhje me qëndrimet e tyre në lidhje me këtë grup.


**Figura 28. Dhuna ndaj grave dhe vajzave është problem serioz në komunitet**



82 përqind e tyre besojnë se vajzat dhe gratë janë më shpesh viktime të dhunës se djemtë dhe burrat. 52 përqind e të rinjve e shohin dhunën ndaj grave dhe vajzave si një problem shumë serioz, 37 përqind mendojnë se është deri diku problem dhe vetëm 9 përqind e të rinjve nuk e shohin si problem në komunitetin ku jetojnë dhunën ndaj grave dhe vajzave.

Më tej të dhënat u grupuan sipas gjinisë dhe sipas rajonit. Nga analiza u vu re se nuk kishte ndryshime në perceptimet e vajzave dhe djemve pjesëmarrës në studim mbi rëndësinë e dhunës ndaj vajzave dhe grave në komunitetin ku ata jetojnë. Ndërkohë ndryshime u vunë re në perceptimet e të rinjve nga rajone të ndryshme.

**Figura 29. Dhuna ndaj grave dhe vajzave është çështje serioze në komunitet.**



Një përqindje më e madhe e të rinjve nga Tirana ishin të mendimit se dhuna ndaj vajzave dhe grave ishte një problem serioz (84 përqind) krahasuar me të rinjtë nga qytete të tjera (70 përqind) dhe fshatra (66 përqind). Më tej, në lidhje me dhunën në marrëdhëniet familjare, të rinjtë, 92 përqind, mendojnë se anëtarët e familjes nuk kanë të drejtë të lëndojnë apo poshtërojnë anëtarët e tjerë të familjes. Megjithatë 31 përqind e tyre janë të mendimit se dhuna në familje është problem vetëm i asaj familjeje ku ndodh dhuna.

### **Të dhëna nga grupet e fokusuar**

Gjetjet nga analiza e diskutimeve në fokus grupe me djem dhe vajza paraqisnin të njëjtën situatë për sigurinë në komunitet, dhe ndanin të njëjtat qëndrime dhe besime rreth dhunës.

Në lidhje me sigurinë në komunitet, vajzat dhe djemtë pjesëmarrës u shprehën se ndiheshin të sigurt në komunitetin ku jetonin si gjatë ditës edhe gjatë natës. Megjithatë të pyetur për situata specifike, vajzat pjesëmarrëse u shprehën se ndjehen përgjithësisht të sigurt, por jo dhe aq kur kthehen orëve të mbrëmjes në rrugë të pandriçuar, në hyrjen e pallateve apo në mjedise të tjera të errëta. Nuk u vunë re komente të tilla mes djemve, në asnjë nga fokus grupet.

*“Unë ndjehem e sigurt në lagjen ku jetoj, megjithatë kur shkoj natën në shtëpi kam frikë në rrugët e pandriçuara, ose tek hyrja e pallatit... Ditën nuk kam frikë” (Vajzë, 17 vjeç, Vlorë, qytet)*

*“Unë kam dëshirë të dal me shoqet në lokalet e bllokut të premtën ose të shtunën pasi më duken shumë të gëzueshme, por nuk lejohem nga prindërit, të cilët në fakt më këshillojnë dhe informojnë për situata të ndryshme, të vështira që kalojnë bashkëmoshataret e mia.” (Vajzë, 16 vjeç, Tiranë).*

Pjesëmarrësit/et në fokus grupe shprehen se ka dhunë në komunitetin ku ata jetonin. Megjithatë mes tyre kishte të rinj që besonin se nuk është dhe aq problem serioz niveli i dhunës. Ata raportuan raste të ndryshme që ishin të njohura në komunitet por edhe raste të tjera më pak të njohura në komunitetin e tyre, apo rrethin e tyre shoqëror. Pjesëmarrësit/et mendonin se dhuna mund të ushtrohet në raste vetëmbrojtjeje megjithatë ata u shprehën se janë kundër dhunës dhe se ajo nuk duhet të përdoret ndaj vajzave. Ata gjithashtu mendojnë se prindërit nuk duhet të ushtrojnë dhunë ndaj fëmijëve por ndodh shpesh që prindërit të ushtrojnë dhunë ndaj fëmijëve.

*“Dhuna është prezente në familjet dibrane. Kemi në shkollë djem e vajza të cilat mendoj që dhunohen në familje, sepse kanë edhe të nxira.” (Peshkopi, djalë 18 vjeç)*

*“Besoj se nuk mund të jap një gjykim të përgjithshëm. Personalisht nuk më duket problem shumë i madh. Mendoj se ka shume vëmendje ndaj grave dhe vajzave nga institucionet ka fushata sensibilizuese që i kanë fuqizuar disi gratë dhe i kanë bërë më të afta të reagojnë. Mbase në zonat e thella ka më shumë dhunë ndërsa këtu nuk më duket shumë problem.” (Vajzë 15 vjeç, Lezhë, qytet)*

*“Një formë e dhunës është edhe përdorimi i rrjeteve sociale. Dikush mund të hapë profil fallco dhe të dëmtojë personin në fjalë. Edhe qëndrimi ndaj viktimave të dhunës është shpesh paragjykes. Edhe në rrjetet sociale individët kërkojnë fajin shpesh tek vajzat e gratë dhe tek arsyeja që i kanë dhënë djemve e burrave për t'i dhunuar. Në raste të ndryshme dhune në Lezhë komuniteti fajëson gratë.” (Vajzë, 16 vjeç, Lezhë, qytet)*

Kishte pjesëmarrës që dhunën ndaj grave dhe vajzave e shihnin si një formë deri diku të përhapur në komunitetin ku jetonin. Ata flisnin kryesisht për dhunën fizike dhe psikologjike. Edhe pse identifikonin ndërhyrjen e bëra nga organizatat e shoqërisë civile për fuqizimin e grave, kishte mes tyre që e shihnin dhunën si një fenomen që ndodhte më shpesh në zonat e izoluara rurale.

*“Për mua është problem serioz. Por asnjëra nga ne nuk arrin ta vlerësojë si duhet për sa kohë nuk e ka përjetuar vetë dhunën. Sidomos mes djemve ka shumë dhunë fizike dhe mes vajzave më e dukshme është dhuna psikologjike. Kam parë forma të dhunës psikologjike, forma të izolimit social dhe të bullizmit.” (Vajzë, 17 vjeç, Lezhë, qytet). Të njëjtin mendim kishin edhe disa nga vajzat nga Tirana.*

*“Gratë dhe vajzat gjykohen dhe prej tyre pritet që të jenë më shumë mbështetëse të familjes dhe punës se sa aktore kryesore të jetës. Duke qenë se paragjykohen më shumë gratë dhe vajzat kjo mund të ndikojë rritjen e nivelit të dhunës ndaj tyre. Paragjykimet dhe diskriminimi i grave mund ta bëjë një grua të ndjehet e paafatë dhe të mos ketë besim në vetvete. Mungesa e besimit e bën atë më të ekspozuar ndaj dhunës.” (Vajzë 18 vjeç, Vlorë, qytet)*

*“Komuniteti ka një ndikim shumë të madh në sjelljen e individëve. Shoqëria jonë pret që vajzat të rrijnë në shtëpi të bëjnë punët e shtëpisë dhe në këtë komunitet është e vështirë të bësh ndryshe. Edhe vetë nënat i ndikojnë vajzat që të përshtaten me atë çfarë komuniteti pret. (vajzë, 17 vjeç, Lezhë, qytet).*

*“Mua më duket sikur të dyja gjinitë paragjykojnë njëra tjetrën. Për shkak të pozicionit inferior që i lihet vajzës dhe gruas në shoqëri ajo shihet më shumë si objekt dhe shpesh herë si objekt seksual. Kjo e bën vajzën më të ekspozuar ndaj dhunës. Mua më duket sikur për këtë arsye gratë i gjykojnë burrat gjithashtu dhe nuk ndihen të sigurta. Ne në shkollën tonë bëjmë çdo vit një shfaqje kundër dhunës me bazë gjinore.” (Vajzë, 17 Vjeç, Lezhë, qytet).*

Pjesëmarrësit në fokus grupe u shprehën gjithashtu jo tolerues ndaj dhunës si mënyrë ndërveprimi. Edhe pse raportuan një sërë rastesh të dhunës nga familja dhe dhunës në marrëdhëniet intime, qëndrimet e tyre ishin kundër çdo lloj forme dhune.

*“Dhuna për mua është cënim i të drejtave njerëzore, askush nuk ka të drejtë të cënojë dikë tjetër për çfarëdo lloj arsye. (Vajzë, 16 vjeç, Lezhë, qytet).*

*“Dhuna duhet përdorur për vetëmbrojtje, megjithatë unë jam kundër dhunës dhe mendoj që nuk duhet përdorur ndaj grave apo vajzave.” (Djalë, 18 vjeç, Peshkopi).*

# Diskutime, reflektime dhe sugjerime në lidhje me dhunën në marrëdhëniet intime në adoleshencë në shoqërinë shqiptare

## Diskutim dhe reflektime në lidhje me dhunën në marrëdhëniet intime në adoleshencë

Rezultatet e studimit tregojnë se dhuna në marrëdhëniet intime në adoleshencë i ka rrënjët e thella në familje dhe në ekspozimin e të rinjve e të rejave ndaj dhunës gjatë gjithë jetës së tyre. Gjetjet flasin qartë për një lidhje të fortë midis përjetimit të dhunës në familje dhe pranimit dhe/apo ushtrimit të saj nga vetë të rinjtë e të rejat kur krijojnë marrëdhëniet e tyre intime. Lidhja e të rinjve që kishin përjetuar dhunë në familje me përfshirjen e tyre në DhMI ishte dukshëm alarmante dhe i përafrohej shifrave të ushtrimit të dhunës ndaj grave e vajzave edhe të studimeve të tjera shqiptare dhe ndërkombëtare. Të rinjtë/rejat që ishin të ekspozuar ndaj dhunës në familje ishin më të prirur të përjetonin apo të ushtronin dhunë edhe në marrëdhëniet e tyre intime.

Megjithëse të rinjtë e të rejat ishin jo tolerues ndaj sjelljeve të dhunshme seksuale, fizike dhe një sërë sjelljesh kontrolluese nga partneri/ja, vihej re se një pjesë e madhe e tyre i konsideronin të pranueshme sjelljet kontrolluese si për veprimtaritë në rrejet sociale, ashtu edhe përcaktimin se me kë mund të shoqërohej ose jo partneri/ja. Më tej ata/ato vetë besonin se qëndrimet, normat dhe sjelljet diskriminuese ishin ndër shkaqet kryesore të DhMI-së. Të rinjtë që ishin ose kishin qenë në një marrëdhënie intime ishin më pranues ndaj të gjitha sjelljeve dhunuese krahasuar me ata që nuk kishin qenë në një marrëdhënie intime. Djemtë krahasuar me vajzat treguan më pak për një përvojë të dhunshme.

Bashkëmoshatarët, prindërit dhe psikologu/ia ishin personat me të cilët të rinjtë do të ndanin një përvojë të dhunës fizike, psikologjike dhe seksuale. Përqindja e të rinjve/rejave që do të kërkonin ndihmë ulej shumë tek ata/ato që kishin qenë ose ishin në një marrëdhënie intime krahasuar me të tjerë që nuk kishin qenë në një marrëdhënie intime ndonjëherë.

Rreth gjysma e të rinjve/rejave që kishin kryer marrëdhënie intime nuk përdornin masa mbrojtëse gjatë kryerjes së marrëdhënieve seksuale dhe vajzat më shumë se djemtë. Kjo e dhënë tepër shqetësuese tregon për nivelin e ulët të edukatës seksuale midis të rinjve shqiptarë. Më tej dhe sipas dëshmimeve në fokus grupet, rreziku për sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe shtatëzanive të padëshiruara është prezent në jetën e të rejave e të rinjve. Shtatëzania e padëshëruar nuk ishte një pyetje në pyetësor por në grupet e fokusuara me vajza, ato treguan raste të shumta të shoqeve të tyre të cilat në shumicën e rasteve abortonin në klinika private.

Rreth moshës 13-14 vjeç një pjesë e të rinjve fillojnë të konsumojnë alkool, duhan dhe një përqindje më e vogël lëndë të ndryshme narkotike. Shqetësues është fakti se të rinjtë/rejat që raportuan se kishin konsumuar duhan, alkool dhe lëndë narkotike gjatë 12 muajve të fundit përbënin një përqindje më të lartë edhe të viktimave të dhunës në marrëdhëniet intime edhe të dhunuesve, krahasuar me të rinjtë që nuk kishin konsumuar substanca gjatë 12 muajve të fundit.

Të dhënat gjithashtu treguan se marrëdhënia mes prindërve dhe të rinjve dominohej nga kontrolli prindëror. Të rinjtë e të rejat diskutojnë më shpesh me prindërit mbi planet e së ardhmes dhe më rrallë për marrëdhëniet e tyre intime. Vajzat diskutojnë më shpesh me prindërit sesa djemtë.

Në lagjen dhe komunitetin ku jetojnë të rinjtë e të rejat ndihen të sigurt, megjithatë vetëm gjysma e tyre do të ndalonte për t'i dhënë informacion një të panjohuri gjatë natës.

Të dhënat më sipër dhe sidomos fakti që 22 përqind e të rinjve/rejave që kishin qenë ndonjëherë në marrëdhënie intime raportojnë të kenë përjetuar dhunë nga partneri/partnerja, kërkojnë urgjentisht strategji dhe politika për të shmangur këtë fenomen i cili ka pasoja të mëdha personale, familjare dhe për shoqërinë. Më tej të dhënat tregojnë për urgjencën e edukimit seksual në lidhje me përdorimin e masave mbrojtëse. Por diskutimet në lidhje me abortet e padëshiruara janë alarm në lidhje me shërbimet e pa monitoruara nga shteti shqiptar në klinikat private nëpër Shqipëri.



## **Sugjerime për veprim në lidhje me dhunën në marrëdhëniet intime në adoleshencë në shoqërinë Shqiptare**

### ***Sugjerime për kërkime të thelluara shkencore***

Çështja e dhunës në marrëdhëniet intime duhet studiuar në të gjitha dimensionet e saj dhe moshat që prek. Lidhja e fortë midis dhunës së përjetuar në familje dhe dhunës në marrëdhëniet intime gjatë adoleshencës është një aspekt i rëndësishëm që duhet analizuar dhe më pas adresuar. Grupet vulnerabël dhe të marxhinalizuara duhet të studiohen me prioritet dhe bazuar në veprimet e tyre si braktisja e shkollës apo martesat e hershme. Studime të tjera afatgjata që analizojnë përvojat e viktimave të dhunës në marrëdhëniet intime do të pasuronin tablonë e informacioneve të nevojshme për të kuptuar më mirë ndikimin e tyre në jetën e të rinjve. Gjithashtu, institucionet shtetërore, akademia dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të marrin përgjegjësi më të mëdha për parandalimin e dhunës në familje dhe asaj në marrëdhëniet intime që fillojnë që në adoleshencë.

### ***Sugjerime për Politika, Ligje e Strategji***

DhMI është fenomen që mund të parandalohet totalisht. Dhuna në marrëdhëniet intime në adoleshencë, mund të jetë një faktor rreziku për dhunë në familje në të ardhmen. Deri më sot në fokusin e studimeve ka qenë dhuna në marrëdhëniet familjare dhe ndikimin që ajo ka tek gratë dhe fëmijët. Dhuna në marrëdhëniet intime mes të rinjve/rejave është një çështje ende e pastudiuar mirë. Ndërkohë që dhuna midis partnerëve/eve është një krim që po raportohet nga viktimat dhe organet policore, dhuna në marrëdhëniet intime në adoleshencë është pothuajse e paraportuar.

A mund të ndërhyhet nëpërmjet parandalimit të hershëm? Prindërit janë ndër aktorët kryesorë të cilët duhet të ndërgjegjësohen për atë çfarë adoleshentët/et përjetojnë dhe që duhet të trajtojnë këtë fenomen si një problem serioz për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Adoleshentët/et gjithashtu nuk dëshirojnë të raportojnë apo të flasin rreth DhMI-së.

E gjithë shoqëria shqiptare duhet të kuptojë rëndësinë e DhMI-së dhe të zhvillojë programe që mund të parandalojnë këtë sjellje. Është shumë e rëndësishme që ky fenomen të trajtohet në kuadër të faktorëve socialë, ekonomik apo normave të pranishme në shoqërinë shqiptare. Duke trajtuar dhunën në marrëdhëniet intime dhe duke diskutuar këtë çështje si shoqëri ne mund të parandalojmë jo vetëm DhMI-në, por edhe dhunën në familje. Është koha që jo vetëm studiuesit, por edhe politikëbërësit t'i japin prioritet dhe ta kenë në fokus të axhendës së tyre marrjen e masave për parandalimin e DhMI në adoleshencë. Të dhënat e studimit

treguan se DhMI është një problem serioz, që ndodh në adoleshencë dhe përfshin një grup të madh të rinjsh e të rejash ndaj kërkon vëmendje publike në nivel kombëtar.

Politikat dhe praktikrat e zhvilluara në këtë drejtim mund të influencojnë jo vetëm shkollat, por edhe organizatat e të rinjve për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin e marrëdhënieve të shëndosha të bazuar në respekt dhe dinjitet. Ligjet dhe politikrat mund të sigurojnë bazën për një qasje gjithëpërfshirëse në lidhje me dhunën në marrëdhëniet intime. Ndërkohë që ekzistojnë një numër i madh ligjesh dhe politikash kundër dhunës në familje apo dhunës ndaj grave, zbatimi mbetet ende pas. Gjendja është akoma më alarmante përse i përket ligjeve dhe politikave kundër DhMI-së në vendin tonë. Masat për forcimin dhe zbatimin efektiv duhet të përfshijnë trajnimin e zyrtarëve që merren jo vetëm me rastet e dhunës në familje, por edhe me rastet e DhMI-së në të gjitha moshat, përfshirë mes adoleshentëve, ngritjen e mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit, si dhe llogaridhënien dhe koordinimin më të mirë. Vënia në përdorim e burimeve të duhura njerëzore dhe financiare është gjithashtu thelbësore. Gjithashtu, ligjet dhe politikrat shpesh mund të luajnë një rol pozitiv në ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve në afat të gjatë, veçanërisht kur ato shoqërohen nga strategji të tilla si ndërgjegjësimi për t'i dhënë fund dhunës. Nëse ligjet janë në fuqi, ata përcjellin një mesazh të fortë se dhuna ndaj grave dhe vajzave apo DhMI-ja nuk tolerohet dhe se është e drejta e çdo individi të jetojë pa dhunë dhe i mbrojtur nga shteti.

## **Propozime për strategji për parandalim të DhMI-së bazuar në përvojat më të mira botërore**

1. **Strategji parandalimi** me fokus shkollat nevojiten për të parandaluar një sërë faktorësh që ndikojnë në zhvillimin e sjelljeve abuzive midis adoleshentëve. Këtu përfshihet të punuarit direkt me adoleshentët, përfshirja e personave që kanë ndikim tek adoleshentët, përdorimi i kanaleve mediatike dhe të komunikimit. Personeli i shkollës është në kontakt të vazhdueshëm me nxënësit kështu që ata duhet të jenë të parët të trajnohen dhe pajisen me njohuri për t'u përgjigjur rasteve të ndryshme. Personeli i shkollës duhet të përgatisë një plan sigurie, mbrojtje dhe këshillimi për adoleshentët në shkollën e tyre. Programet e parandalimit duhet të integrohen në kurrikula të posaçme dhe në orë ekstra-kurrikulare. Të gjitha këto strategji duhet të përshtaten sipas moshës dhe kontekstit social-kulturor. Shërbimet psiko-sociale në shkollë duhet të fuqizohen, duke shtuar numrin e psikologëve dhe të punonjësve socialë me qëllim zgjerimin e shërbimeve psiko-sociale jo vetëm për të rinjtë që kërkojnë vetë ndihmë, por edhe për të trajtuar ciklin e dhunës në përgjithësi e sidomos te ata që nuk e raportojnë. Një rol të rëndësishëm parandalues në shkollë luajnë

edhe mësuesit apo punonjësit e tjerë të cilët mund të identifikojnë raste të ndryshme kur të rinjtë janë të përfshirë në DhMI duke monitoruar sjelljen e tyre dhe duke ofruar ndihmë sipas rasteve.

2. **Strategji që mund të aplikohen që në shkollat 9-vjeçare.** Para-adoleshenca është një periudhë e cila mund të shfrytëzohet për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme ndërkohë që adoleshentët janë kuriozë dhe fillojnë të eksplorojnë marrëdhëniet e para intime apo të lexojnë rreth tyre. Ndaj në këtë fazë sugjerohet të ofrohet mbështetje e fortë përmes moduleve të ndryshme të cilat duhet të trajtohen në orët mësimore apo në takimet me psikologun/un e shkollës. Ky edukim do t'i paraprinte shumë faktorëve të rrezikshëm që mund të ndikojnë në zhvillimin e reagimeve të dhunshme.
3. **Përfshirja e të rinjve, fuqizimi i lidershit.** Zëri i të rinjve/të rejave është shumë kritik për një parandalim të suksesshëm të dhunës në marrëdhëniet intime. Të rinjtë/rejat ndikojnë tek moshatarët e tyre, sidomos më të rriturit ndaj atyre më të vegjël. Media sociale është një platformë e mundshme për përfshirjen e të rinjve/rejave. Kështu shkollat vetë mund të krijojnë hapësirë në mediat sociale për të rinjtë e të rejat që duan të shkruajnë rreth problemeve që i shqetësojnë. Ka të rinj e të reja që janë avokatë të fuqishëm për çështje që ndikojnë jetët e tyre, të cilët ndonjëherë i japin leksione mirësjellje edhe të rriturve. Duke i trajtuar të rinjtë si lider të ardhshëm, ata do të zhvillojnë kapacitete për partneritete ndër breza dhe ndryshime positive në komunitet.
4. **Përfshirja e prindërve dhe komunitetit në shkollë.** Prindërit apo kujdestarët janë një forcë parësore dhe model për fëmijët e tyre. Ata gjithashtu me veprimet e tyre ndikojnë politikat vendore dhe legjisllacionin. Na fakt, prindërit duhet të angazhohen për shumë çështje në shkolla jo vetëm për DhMI. Përfshirja e prindërve duhet të ketë një protokoll të veçantë dhe të mos jetë fiktive. Me prindërit nuk duhen diskutuar vetëm arritjet akademike, por edhe çështje të zhvillimit psiko-social sidomos në periudhën e kalimit nga shkolla 9-vjeçare në shkollën e mesme.
5. **Nevojiten më shumë të dhëna rreth DhMI-së mes adoleshentëve, për të parandaluar këtë fenomen.** Për ta trajtuar DhMI-në si një prioritet të edukimit dhe shëndetit publik dhe për t'i mëshuar më shumë programeve dhe politikave të parandalimit të DhMI, nevojiten të dhëna të besueshme, rreth çështjeve të ndryshme lidhur me këtë fenomen, si psh., prevalenca dhe dinamika e DhMI-së në qarqe të ndryshme; studimi i thelluar në lidhje me ndikimin e dhunës në familje dhe dhunës në marrëdhëniet intime në adoleshencë; roli i kontrollit prindëror në parandalimin e DhMI-së; matja e mendimit të prindërve dhe kujdestarëve në lidhje me DhMI. Të dhënat e këtij studimi përbëjnë një pikënisje shumë të mirë për fillimin e ndërhyrjeve të para parandaluese, pasi shumica e gjetjeve krijojnë mundësi për studime të thelluara në çështje të tjera.

6. **Ndryshimi i politikave në nivel vendor në lidhje me DhMI është i mundur.** Anëtarët e mekanizmit të referimit (MKR) mund të luajnë një rol kyç në parandalimin e DhMI-së. Duke qenë se përfaqësuesit e sistemit arsimor janë pjesë e MKR-së ata duhet të vijjnë në takimet e MKR-së me ide dhe plane konkrete për parandalimin e DhMI-së dhe me njohuri për lidhjen e DhMI-së me dhunën në familje. Adoleshentët, viktimat të dhunës në familje, duhet të marrin shërbim orientues pranë shkollave nga profesionistët të punës sociale dhe psikologjisë. DhMI duhet të konsiderohet ndryshe dhe të mos trajtohet si bullizëm apo ngacmim seksual. Ndryshimi i politikave lokale mund të fillojë me hapa të vegjël, si p.sh. Informimi i politikëbërësve rreth këtij fenomeni dhe përpjekjeve aktuale për ta trajtuar këtë çështje. Sidoqoftë MKR ofron një platformë ideale për trajtimin e DhMI-së pasi do të parandalonte dhunën në familje që është objekt i punës së MKR-së.
7. **Gjithashtu është i nevojshëm ndryshimi i politikave në mbarë vendin.** Duke pasur parasysh klimën e vështirë të buxhetit të shtetit, një axhendë politike e fortë dhe një koalicion i gjerë i aleatëve kundër dhunës, është i nevojshëm për t'ia dalë mbanë kundër DhMI-së e më tej kundër dhunës në familje. Disa nga objektivat mbarëkombëtare, të tilla si, përgatitja e një pakete burimesh të fokusuar në parandalimin e DhMI-së lehtësisht e aksesueshme për shkollat, mund të arrihet përmes advokimit në nivel qendror e vendor. Ministria e Arsimit dhe Rinisë nuk duhet të rrijë indiferente ndaj këtij fenomeni, por të marrë masa paralelisht me aspektet akademike.
8. **Një qasje holistike mund të lidhë parandalimin e DhMI-së me çështje të tjera të politikave.** Ndërkohë që politikat dhe ligjet për të parandaluar apo ndëshkuar dhunën dhe abuzimin në marrëdhëniet intime mes adoleshentëve mungojnë dhe nevojiten, përsëri mendohet se këto politika do të ishin të pamjaftueshme për të parandaluar DhMI-në. Një qasje holistike thekson rëndësinë e një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës shkollor në të cilin mësohen, modelohen dhe përforcohen marrëdhëniet e respektueshme, të barabarta dhe jo të dhunshme. Kjo qasje pozitive e lidh parandalimin e DhMI-së me nisma të tjera edukative, të tilla si nxitja e mbështetjes pozitive të sjelljes dhe të mësuarit social-emocional bazuar në eksperiencat e vendeve të zhvilluara.

Adoleshenca është një periudhë eksplorimi, tranzicioni dhe zhvillimi social dhe programet e parandalimit duhet të përshtaten brenda këtij konteksti. Gjithashtu këto programe duhet të synojnë ndryshimin e sjelljeve të dhunshme dhe jo vetëm qëndrimet në lidhje me DhMI-në. Adoleshentët janë një grup i lënë në harresë nga këndvështrimi gjinor dhe social - emocional, megjithëse adoleshenca është një periudhë e rëndësishme në jetën e njeriut. Për zhvillimin e programeve efektive të parandalimit nevojitet kryerja e studimeve afatgjata sidomos rreth faktorëve të rrezikshëm për DhMI-në midis adoleshentëve.

Në vendet e zhvilluara ekzistojnë një sërë programesh parandalimi dhe ndërhyrjeje që krijojnë mundësi për t'u aftësuar për jetën dhe që nxisin marrëdhënie të shëndosha, jo të dhunshme. Një pjesë e mirë e këtyre programeve fokusohen në ndryshimin dhe përmirësimin e njohurive, qëndrimeve dhe sjelljeve që lidhen me DhMI-në duke u përqëndruar në aftësimin e të rinjve për të ndërtuar marrëdhënie të mira ndërpersonale. Këto programe zbatohen në nivel familjeje, shkolle, apo komuniteti. Sidomos programet e vendeve të zhvilluara, në nivel shkolle, që fokusohen me shumë tek të rinjtë dhe bashkëmoshatarët e tyre për të ndryshuar jo vetëm qëndrimet, por edhe sjelljet e lidhura me DhMI-në, rezultojnë shumë të suksesshme.

### ***Programe të ndryshme sociale që duhet të fillojnë që nga klasa e 7-të apo e 8-të***

Përfshirja në programet psiko-sociale nxisin pritshmërinë për një marrëdhënie reciproke të respektueshme, me përkujdesje reciproke, jo të dhunshme. Programet e suksesshme jo vetëm që japin aftësi për marrëdhënie të sigurta dhe të shëndetshme, por gjithashtu ofrojnë mundësi të shumta për të praktikuar dhe përforcuar këto aftësi. Këto programe zbatohen në shkolla në vende si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Suedi etj.

*Por pse duhet të reagojnë shkollat ndaj DhMI-së?* Së pari, shkolla është një ambient ku dhunuesi dhe viktimi ndërveprojnë me njëri-tjetrin më shumë se në çdo ambient tjetër. Së dyti, shkolla e ka për detyrë të mbrojë nxënësit e saj ndaj çdo lloji dhune që mund t'u kanoset atyre. Së treti, shkolla ka mundësi të adresojë sjelljet abuzive të adoleshentëve më shumë se çdo institucion tjetër. Së fundmi dhe më e rëndësishmja, shkolla ka të gjithë autoritetin për të zbatuar rregullat dhe politikat ndaj sjelljeve të nxënësve me qëllim mbrojtjen e tyre dhe të stafit. Mbi të gjitha shkollat duhet të bëjnë përpjekje për të promovuar marrëdhënie të shëndosha dhe për të parandaluar DhMI-në midis adoleshentëve me qëllim përmirësimin e shëndetit të të rinjve dhe për të garantuar sigurinë dhe arritjet akademike.

Programet e marrëdhënieve të shëndetshme për çiftet fokusohen në përmirësimin e dinamikës së marrëdhënieve dhe mirëqenies individuale duke përmirësuar komunikimin, menaxhimin e konfliktit dhe aftësitë e rregullimit emocional. Ofrimi i trajnimeve për sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe metodave të kontracepsionit për të shmangur sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe shtatëzanitë e padëshiruara.

Këto programe që sugjerohen më poshtë janë marrë nga botimi: Parandalimi i dhunës në marrëdhëniet intime gjatë jetës: Një paketë teknike programesh, politikash dhe praktikash i hartuar në 2017 nga Niolon, Kearns, Dills, Rambo, Irving, Armstead, Gilbert.

Një program socio – emocional, i provuar efikas është **Safe Date – Takimi i Sigurt**, i cili bazohet në promovimin e marrëdhënieve të shëndosha dhe parandalimin e DhMI-së. Ky program fillimisht zhvillohet në klasën e 8-të dhe të 9-të, me 10 sesione diskutimi në klasë. Programi ofron mundësi për studentët të mësojnë aftësitë praktike në lidhje me zgjidhjen e konflikteve, komunikimin pozitiv dhe menaxhimin e zemërimit.

Një shembull tjetër është programi **Strategjia e katërt**, dedikuar marrëdhënieve të shëndosha me adoleshentë. Programi quhet kështu për të treguar se marrëdhëniet janë po aq të rëndësishme sa lëndët mësimore bazë si leximi, shkrimi dhe arithmetika. Ky program jepet në 21 seanca dhe fokusohet në: sigurinë personale dhe parandalimin e lëndimit; edukimin për marrëdhënie seksuale të shëndetshme, dhe mësim kundër abuzimit me substancat. Programet shoqërohen me trajnime dhe fushata ndërgjegjësuese për dhunën në marrëdhëniet intime mes të rinjve.

Një program tjetër i parandalimit të DhMI-së midis adoleshentëve është **edhe Programi i Marrëdhënieve të Shëndosha** i cili bazohet në dy parime: 1) Të gjithë meritojnë të ndiehen të sigurtë dhe të respektuar në një marrëdhënie intime, dhe 2) Nuk ka asnjë justifikim për dhunën, kurrë. Ky program ofrohet për nxënësit nga klasa e 7-të-12-të. Fillimisht ky program u drejton disa pyetje nxënësve të shkollave 9-vjeçare duke i pyetur ata se çfarë do të thotë për ta një miqësi apo marrëdhënie e shëndoshe. Më pas nxënësit mësojnë rreth ndryshimeve midis flirtimit dhe abuzimit seksual dhe rëndësisë për të vendosur kufinj. Ndërsa nxënësit e shkollave të mesme prezantohen me një tablo më të gjerë të DhMI-së dhe parandalimit të saj. Gjithashtu, njohuritë rreth ngacmimit dhe sulmit seksual bëhen pjesë e kurrikulës së këtij programi. Të rinjtë duhet të përkrahen me të gjitha mjetet e mundshme për të parandaluar DhMI-në. Ata duhet të përfshihen herët në biseda që shpjegojnë konceptin e dashurisë dhe për të vendosur një normë të re për atë që përbën një marrëdhënie të shëndetshme. Ky program gjithashtu u kërkon nxënësve të shqyrtojnë stereotipet tradicionale gjinore dhe rolin që këto luajnë në përjetimin e DhMI-së.

Rezultatet e mundshme që mund të arrihen përmes këtyre programeve janë:

- Rritja e përdorimit dhe ruajtjes së të aftësive të marrëdhënieve të shëndetshme;
- Rënie të dhunës fizike, seksuale dhe emocionale në marrëdhëniet intime;
- Reduktimet të rasteve të dhunës midis bashkëmoshatarëve, përfshirë ngacmimin;
- Reduktime në sjelljet seksuale me rrezik të lartë;
- Ndryshimi i qëndrimeve pranuese ndaj dhunës në marrëdhënie;
- Zhvillimi i të menduarit kritik rreth roleve gjinore, stereotipeve, media dhe sesi këto ndikojnë në marrëdhëniet intime;

- Zhvillimi dhe përdorimi i mjeteve (p.sh linjat e shërbimeve online) për t'u ardhur në ndihmë miqve që dhunohen apo janë dhunues;
- Rritja e nivelit të kënaqësisë dhe mirëqenies në marrëdhëniet intime;
- Kufizim në abuzimin e substancave;
- Shmangia në mbajtjen e armëve.

### ***Përfshirja e shembujve dhe njerëzve pozitivë***

Promovimi i ndikimeve dhe modeleve pozitive duke dënuar sjelljet e dhunshme dhe jo të shëndetshme të marrëdhënieve mes adoleshentëve dhe të rinjve në moshë të hershme janë kritike për parandalimin e DhMI-së. Të rriturit dhe bashkëmoshatarët e besuar kanë ndikim të rëndësishëm në jetët e të rinjve me shembujt e tyre. Besimet dhe qëndrimet pranuese të dhunës dhe diskriminimit për shkak të gjinisë janë parakushte për ndodhjen e DhMI-së. *Duke qenë se bashkëmoshatarët janë burimi i parë i mbështetjes së të rinjve në rast përballje me dhunën në marrëdhëniet intime, ofrimi i trajnimeve të të rinjve jo vetëm për të ndërgjegjësuar veten, por edhe për të ndihmuar miqtë e tyre në vështirësi do t'i vinte në ndihmë viktimave të DhMI-së.* Trajnimi i bashkëmoshatarëve bëhet për t'i mbështetur, si dhe për t'i orientuar rastet e dhunuesve drejt shërbimeve mbështetëse. Të dhënat tregojnë se si dhunuesit edhe viktimat i përkasin të njëjtit konteksti psiko-social, pra vijnë nga familje dhe mjedise të dhunshme.

Ka një numër qasjesh që kërkojnë të ndikojnë në kontekstin social brenda të cilit ndodh dhuna në marrëdhëniet intime, duke angazhuar bashkëmoshatarët dhe të rriturit me influencë.

***Burrat dhe djemtë si aleatë në parandalim.*** *Kjo qasje synon burrat dhe djemtë dhe i inkurajon ata të jenë pjesë e përpjekjeve për të parandaluar DhMI-në, duke përfshirë dhunën në adoleshencë. Këto qasje jo vetëm që inkurajojnë burrat dhe djemtë të promovojnë normat shoqërore që zvogëlojnë rrezikun e kryerjes së DhMI-së, por dhe mbështet viktimat e mundshme duke ndërhyrë për të biseduar me ta. Këto qasje shpesh i drejtojnë djemtë në grupe bashkëmoshatarësh, siç janë ekipet sportive apo tjetër.*

***Programet për familjen*** kërkojnë të përfshihen prindërit dhe kujdestarët e tjerë në parandalimin e DhMI-së. Këto programe veprojnë bazuar në rëndësinë e familjes në zhvillimin e normave dhe vlerave pozitive dhe prandaj janë të përshtatshëm për ndërhyrjet që promovojnë sjellje të pranueshme. Këto qasje janë të dizenuara për të përmirësuar vetëdijen prindërore dhe njohuritë mbi DhMI-në, për të ndryshuar qëndrimet prindërore në lidhje me pranueshmërinë e DhMI-së, si dhe për përmirësimin e komunikimit prindëror me fëmijët rreth DhMI-së.

Rezultatet që arrihen nga zbatimi i këtyre programeve

- Reduktimi DhMI-së.
- Rritja e efikasitetit të prindërve/kujdestarëve në zgjidhjen e konflikteve në marrëdhënie me adoleshentët dhe angazhimin e tyre në vendosjen e rregullave.
- Reduktime në pranimin e abuzimit në marrëdhëniet intime në adoleshencë.



# Referenca

- Ackard, D. M., & Neumark-Sztainer, D. (2002). Date violence and date rape among adolescents: Associations with disordered eating behaviors and psychological health. *Child abuse & neglect*, 26(5), 455-473.
- Albanian Women Empowerment Network. 'Report on the Implementation of the Council of Europe Convention on Preventing and Combating Violence Against Women and Domestic Violence in Albania,' December 2016.  
Received from: <http://awenetwork.org/wp-content/uploads/2017/01/DraftIstanbulConvention-Monitoring-Report-1-1.pdf>.
- Albanian Helsinki Committee. (2017). Report on the situation of respect for human rights and freedoms in Albania during 2016.  
Available at [http://ahc.org.al/wpcontent/uploads/2017/04/Albanian\\_2016\\_Human-Rights-Report\\_AHC\\_ENG.pdf](http://ahc.org.al/wpcontent/uploads/2017/04/Albanian_2016_Human-Rights-Report_AHC_ENG.pdf).
- Allison, B. N., & Schultz, J. B. (2004). Parent-adolescent conflict in early adolescence. *Adolescence*, 39(153), 101-120.
- Archer, J. (2006). Cross-cultural differences in physical aggression between partners: A social role analysis. *Personality and social psychology review*, 10, 133-153.
- Banyard, V. L., & Cross, C. (2008). Consequences of teen dating violence: Understanding intervening variables in ecological context. *Violence against women*, 14(9), 998-1013.
- Billy, J. O., Brewster, K. L., & Grady, W. R. (1994). Contextual effects on the sexual behavior of adolescent women. *Journal of marriage and the family*, 387-404.
- Brendgen, M., Vitaro, F., Tremblay, R. E., & Wanner, B. (2002). Parent and peer effects on delinquency-related violence and dating violence: A test of two mediational models. *Social development*, 11(2), 225-244.
- Bell, K. M., & Naugle, A. E. (2008). Intimate partner violence theoretical considerations: Moving towards a contextual framework. *Clinical psychology review*, 28(7), 1096-1107.
- Ben-Arieh, A., McDonnell, J., & Attar-Schwartz, S. (2009). Safety and home-school relations as indicators of children well being: whose perspective counts? *Social indicators research*, 90(3), 339-349.
- Black, B. M., Tolman, R. M., Callahan, M., Saunders, D. G., & Weisz, A. N. (2008). When will adolescents tell someone about dating violence victimization? *Violence against women*, 14(7), 741-758.

- Breiding, M. J. (2014). Prevalence and characteristics of sexual violence, stalking, and intimate partner violence victimization—National Intimate Partner and Sexual Violence Survey, United States, 2011. *Morbidity and mortality weekly report. Surveillance summaries* (Washington, DC: 2002), 63(8), 1.
- Brooks-Russell, A., Foshee, V. A., & Ennett, S. T. (2013). Predictors of latent trajectory classes of physical dating violence victimization. *Journal of youth and adolescence*, 42(4), 566-580.
- Buka, S.L., Stichick, T.L., Birdthistle, I., Earls, F.J. (2001). Youth exposure to violence: prevalence, risks, and consequences. *American journal of orthopsychiatry*, 71, 298–310.
